

**DOKUMENTIMI DHE VALORIZIMI I ARKITEKTURËS VERNAKULARE NË
KOSOVË**

TEMA PËR TITULLIN
MASTER I SHKENCËS NË ARKIVISTIKË

NGA

ULPIANA RUHANI BOROVA



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I HISTORISË
PROGRAMI : ARKIVISTIKË

Prishtinë, 2022

MARS, 2022

**DOKUMENTIMI DHE VALORIZIMI I ARKITEKTURËS VERNAKULARE NË
KOSOVË**

Tema e prezantuar

nga

Ulpiana Ruhani Borova

pranë

DEPARTAMENTIT TË HISTORISË

në plotësimin e pjesëshëm të obligimeve

për të fituar titullin

Master i shkencës në arkivistikë

MARS, 2022



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

FAKULTETI FILOZOFIK

Prishtinë

Aprovuar nga:

Prof. Ass. Dr. Arben Hajdari

Emri Mbiemri, Titulli, Mentor

Data

Prof. Dr. Muhamet Mala

Emri Mbiemri, Titulli, Anëtar

Data

Prof. Ass. Dr. Kujtime Boshtrakaj

Emri Mbiemri, Titulli, Anëtar

Data

**DOCUMENTATION AND VALORIZATION OF VERNACULAR ARCHITECTURE IN
KOSOVO**

Dissertation presented

by

Ulpiana Ruhani Borova

at the

DEPARTMENT OF HISTORY

Submitter in partial fulfilment of the requirements for

the degree of

Master of Sciences in Archives

MARCH 2022



UNIVERSITY OF PRISHTINA

FAKULTY OF PHILOSOPHY

Prishtina

Approved by:

Prof. Ass. Dr. Arben Hajdari

Name Surname, Title, Mentor

Date

Prof. Dr. Muhamet Mala

Name Surname, Title, Member

Date

Prof. Ass. Dr. Kujtime Boshtrakaj

Name Surname, Title, Member

Date

© 2022 - Ulpiana Ruhani Borova

Të gjitha të drejtat të rezervuara.

Dedikimi

Nënës sime, Kimetes, e cila kurrë nuk u dorëzua pranë asgjëje dhe për mbështetjen që ma jep në çdo hap të jetës sime!

Falënderime

Gjatë hartimit të kësaj teze masteri jam ndihmuar dhe mbështetur nga një numër njerëzish, të cilët do doja t'i falënderoj me këtë rast. Së pari dëshiroj të falënderoj mentorin tim, profesorin Arben Hajdarin pa ndihmën, udhëzimet dhe profesionalizmin e të cilit hulumtimi im nuk do të mund të bëhej. Së dyti dëshiroj të falënderoj anëtarët tjerë të komisionit, të cilët me vlerësimet dhe sugjerimet e tyre kontribuan në ngritjen e nivelit profesional të kësaj teme masteri, e cila është e një rëndësie të posaçme për trashëgiminë kulturore në Kosovë. Gjithashtu, dua të falënderoj të gjithë kolegët dhe profesorët tjerë për mbështetjen e tyre përgjatë studimeve master.

Së fundmi, por jo edhe nga rëndësia, dëshiroj të falënderoj nënën time, bashkëshortin dhe tre djemt e mi për mbështetjen që ma ofruan gjatë studimeve dhe që besuan në mua!



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”

UNIVERSITAS STUDIORUM PRISHTINIENSIS

FAKULTETI FILOZOFIK

Nëna Terezë, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +381 38 224 783, Fax: +381 38 244 035,

E-mail: filozofiku@uni-pr.edu, www.uni-pr.edu

FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I HISTORISË
DEKLARATË

PËR NDERSHMËRI AKADEMIKE

Me anë të kësaj deklarate, unë, Ulpiana Ruhani Borova, duke ditur përkufizimin dhe format plagjiaturës në botën akademike dhe duke iu referuar dokumenteve në fuqi në Universitetin e Prishtinës ‘Hasan Prishtina’ (statuti i UP-së neni 134, pika 2.2), deklaroj, që:

- a) punimi i paraqitur këtu është origjinal dhe është kryer personalisht nga unë;
- b) punimi nuk është marrë nga studentë të tjerë apo punime të tjera në Universitetin e Prishtinës ‘Hasan Prishtina’ ose nga ndonjë universitet tjetër;
- c) punimi nuk është kopje e ndonjë punimi të marrë në internet apo bibliotekë;
- ç) punimi nuk përmban modifikim të dhënash, duke i paraqitur ato si personale;
- d) punimi respekton të gjitha kërkesat për të drejtat e autorit, duke saktësuar dhe cituar të gjitha kontributet nga burimet e tjera .

Punimi i diplomës në fjalë vlen për nivelin Master të studimeve dhe mban titullin

“Sistemi i Menaxhimit zyrtar dhe Arkivor ne organet Qeveritare të Kosovës”

Me nënshkrimin e kësaj deklarate, vërtetoj , se çfarë u tha më sipër është e vërtet dhe për çdo gjë të vërtetuar ndryshe mbaj përgjegjësi personalisht.

Prishtinë , më 01.03.2022

Studentja-nënshkrimi _____

ABSTRAKTI

DOKUMENTIMI DHE VALORIZIMI I ARKITEKTURËS VERNAKULARE NË KOSOVË

Nga

Ulpiana Ruhani Borova

Mentori: Arben Hajrullahu, Prof. Ass. Dr.

Ky punim do të trajtoj çështjen e trashëgimisë kulturore, e në veçanti arkitekturën tradicionale në Kosovë. Qëllimi i këtij hulumtimi është që të kuptohet më mirë sistemi i dokumentimit të objekteve me arkitekturë kombëtare, ndërtimi dhe dekorimi, si dhe ruajtja e tyre. Më konkretisht, do të hulumtohen tri objekte të shekullit XVIII dhe XIX në Kosovë, dokumentacioni i të cilave do të kërkohet në arkivën e Kosovës, si dhe do të hulumtohet ruajtja e tyre ndër shekuj. Këto objekte janë: (1) Shkolla fillore “Elena Gjika” (Prishtinë), (2) Ish Hotel Unioni (Prishtinë), dhe (3) Ndërtesa e Akademisë së Arteve dhe Shkencave të Kosovës (Prishtinë). Studimi do të jetë kualitativ, do të hulumtohet literatura përkatëse si dhe do të bëhet analizë e dokumenteve të arkivuara në arkivën e Kosovës, Prishtinë. Hulumtimet e deritanishme tregojnë mangësitë në sistemin e dokumentimit të këtyre objekteve. Evidencat mbështesin brengat që efektet negative të mosruatjes dhe mosdokumentimit të këtyre objekteve. Në mënyrë që të krijohen strategji të reja dhe të implementohen koncepte të reja, është shumë e rëndësishme që të adresohen këto çështje me urgjencë.

Fjalët kyçe: *Dokumentimi dhe valorizimi i arkitekturës vernakulare në Kosovë..*

Abstract

This study will explore the cultural heritage – traditional architecture in Kosovo. The aim of this research is to better understand the documentation system of the traditional architecture objects, their construction, decoration and preservation. More specifically, for the purposes of this research there will be researched the following traditional objects: (1) Elementary School “Elena Gjika” (Prishtina), (2) Former Hotel Union (Prishtina), and (3) The former Academy of Arts and Science of Kosovo (Prishtina). The study will be qualitative, document and literature review and research documents in the archives. Research has shown that there are many gaps in the system of documentation of these objects, if there are any. The evidence shows the concerns about the negative effects of their non-documentation and non-preservation. In order to achieve strategies and implement new concepts, it is important to address these issues with a sense of urgency.

Key words: *Documentation and valorization of vernacular architecture in Kosovo.*

PËRMBAJTJA

Hyrje.....	13
Arsyeshmëria e temës	14
Qëllimi i punimit	15
Metodologjia e hulumtimit.....	16

KAPITULLI I PARË

VËSHTRIM MBI TRASHËGIMINË KULTURORE NË KOSOVË	16
1.1 Trashëgimia kulturore në Kosovë	16
1.2. Historiku i shkurtër i Republikës së Kosovës.....	19
1.3. Objektet tradicionale dhe rëndësia e tyre.....	20
1.4. Historiku i shkurtër i qytetit të Prishtinës.....	21
1.5. Llojet e objekteve të arkitekturës tradicionale në Kosovë.....	22
1.6. Arkitektura në Kosovën e viteve të pasluftës.....	36

KAPITULLI I DYTË

HULUMTIMI, ANALIZA DHE GJENDJA E MONUMENTEVE TRADICINALE.....	42
2.1. Metodologjia e hulumtimit dhe analiza e evidentimit dhe gjendjes së monumenteve tradicionale në Prishtinë.....	42
2.2. Kulla si banesë shqiptare - pjesë e arkitekturës tradicionale	
2.3. Objektet arkitektonike në Kosovë të përfshira në hulumtim.....	43
2.4. Shkolla fillore “Elena Gjika” (Prishtinë).....	44
2.5. Ish Hotel Unioni (Prishtinë).....	47
2.6. Ndërtesa e Akademisë së Arteve dhe Shkencave të Kosovës (Prishtinë).....	50

KAPITULLI I TRETË

MBROJTJA DHE RUAJTJA E ARKITEKTURË TRADICINALE	51
3.1. Trajtimi dhe ruajtja e aseteve të arkitektures tradicionale	52
3.2. Konservimi dhe restaurimi.....	52
3.3. Korniza ligjore	53
Konkluzionet.....	54
Burimet dhe literatura.....	57

LISTA E FIGURAVE:

Figura 1 - Dukja perspektive e “kullës me karollhane”, fshati Popaj, Malësi e Gjakovës.	21
Figura 2 - Dukja perspective e hambarit karakteristik, ndërtuar në kompleksin jashtëzakonisht të zhvilluar të teqesë Harabati në Tetovë.	23
Figura 3 - Magje tipike, rrethina e Mitrovicës, daltuar me ornamente kultike dhe zbukuruese në gjithë ballin e saj	25
Figura 4 - Djepi me ornamentikë zbukurimore të karakterit të kombinuar: gjeometrik dhe imësor	24
Figura 5 - Çarshia e vjetër e qytetit të Pejës, para luftës së fundit në Kosovë.....	26
Figura 6 - Çarshia e re e qytetit të Pejës	27
Figura 7 - Qarshia e vjetër e Gjakovës, para luftës se fundit në Kosovë.....	27
Figura 8 - Qarshia e rrënuar në Gjakovë, gjatë luftës së fundit në Kosovë	28
Figura 9 - Foto e realizuar nga Sh. Obërtinca, Shkolla e mesme Xhevded Doda në Prishtinë ...	29
Figura 10 - Foto e realizuar nga U. Borova me datën: 19/9/2019, Katedralja Nënë Tereza në Prishtinë	30
Figura 11 - Qyteti Prishtinës, 2010 NewBorn.	31
Figura 12 - Kulla e Haxhi Zekës, Pejë.....	36
Figura 13 - Kulla e Osëdutajve, Isniq (Deçan).	36
Figura 14 - Kulla e Isa Boletinit, Boletin (Mitrovicë).	37
Figura 15 - Dobroshec, Glllogoc, Ylli i Davidit me hëne dhe yll.....	38
Figura 16 - Luanët në dritaren e odes se burrave.....	39
Figura 17 - Kulla e Zenel Begut - Oda e burrave.....	41
Figura 18 - Oda e Burrave - Trapazi.....	40
Figura 19 - Dekoracione në oxhakun e odës së burrave.....	41
Figura 20 - Dollap i bukës në orën e burrave	40
Figura 21 - Pejë Detaj Tavani.....	42
Figura 22 - Dekoracione-Rozeta.....	41
Figura 23 - Shkolla fillore “Elena Gjika.....	43
Figura 24 - Ish-Hotel Unioni, Prishtinë.	44
Figura 25 - Ish Hotel Skender Beg në vitin 1923, në kohën kur kishin arritur veturat e para në Prishtinë.	44
Figura 26 - Ndërtesa e ish Akademisë së Shkencave dhe Arteve.....	46

Hyrje

Objekte arkitektonike tradicionale ka nëpër tërë Kosovën, dhe janë dy lloje: shtëpitë nga guri (kullat) dhe shtëpitë. Duke pasur shtrirje në Evropën jug-lindore, arkitektura në Kosovë është e ngjajshme me atë në regjion sa i përket teknikave të ndërtimit, përdorimit të materialeve si dhe shprehjes arkitektonike. Luftërat e shumta dhe sundimet nga popuj të ndryshëm gjithashtu kanë pasur mjaft ndikim në ndërtimin, dokumentimin dhe ruajtjen e këtyre objekteve. Ligji Nr. 02/L-88 për Trashëgiminë kulturore e rregullon ruajtjen e ndërtesave urbane apo rurale të dalluara për nga vlerat historike, arkeologjike, artistike, shkencore, me interes shoqëror si dhe inventarizimin, dokumentimin dhe mbrojtjen e përkohshme të tyre (Ligji Nr.02/L-88, 2008). Megjithatë, hulumtimet përkatëse tregojnë se objektet e arkitekturës tradicionale në Kosovë janë në gjendje jo të mirë dhe për to nuk ka dokumentacion të mjaftueshëm.

Hulumtimet e shumta kanë treguar për shkatërrimin e trashëgimisë kulturore e sidomos objekteve tradicionale në Kosovë. Sipas autorëve Herscher dhe Riedlmayer tërheqja e autonomisë së Kosovës në vitin 1998 dhe gjendja e jashtëzakonshme bëri që shqiptarët të largohen nga të gjitha institucionet publike dhe shkelja e të drejtave njerëzore nga forcat e shërbimit serb çuan në eskalimin e tensioneve mes shqiptarëve dhe qeverisë serbe.¹ Shtypja e vazhdueshme që u bëhej shqiptarëve si dhe dështimi i rezistencës paqësore çoi te krijimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Gjendja e rënduar ndikoi që populli shqiptar i Kosovës të largohet me dhunë nga forcat serbe, nga shtëpitë e tyre dhe arkitektura historike që ndërlidhej me popullin shqiptar u bë synim i shkatërrimit me qëllim që populli të mos ketë ku të kthehet si dhe të fshiheshin gjurmët e deportimit të tyre. Objektet e para të veçuara për t'u shkatërruar në vitet 1998 dhe 1999 ishin xhamitë; së paku 207 e rreth 609 xhamive në Kosovë janë dëmtuar apo shkatërruar gjatë kësaj kohe. Synim i forcave serbe ishin edhe objektet tjera arkitektonike si shtëpitë islamike fetare dhe libraritë, më shumë se 500 kulla si dhe pazaret historike. Tri nga katër bërthamat e mirë-ruajtura Otomane urbane në qytetet e Kosovës gjithashtu ishin shkatërruar duke shkaktuar humbje të madhe të arkitekturës historike. Komisioni i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë ka vlerësuar që në Kosovë, nga marsi deri në qershor 1999 janë shkatërruar 70,000 shtëpi.²

¹ Herscher, A., & Riedlmayer, A. (2000). Monument and Crime: The Destruction of Historic Architecture in Kosovo. *Grey Room*, (1), 108-122.

² *Ibid.*

Arsyeshmëria e temës

Termi Arkitekturë i referohet përcaktimit të hapësirës, dhe është arti i konstruktimit të hapësirave që nevojiten për të lehtësuar jetën e njeriut dhe për t'u mundësuar atyre që të strehon dhe kryejnë aktivitete si pushimi, puna dhe zbavitja³. Arkitektura popullore sipas Dolit (2009) është “prodhim spontan dhe i qëndrueshëm i veprimitarisë së një populli të tërë me një trashëgimi të përbashkët” (fq.18). Për më tepër, kjo arkitekturë tek populli shqiptar zë fill që nga periudha parahistorike e neolitit e deri në ditët e tona. Arkitektura vernakulare e Kosovës, që nga zanafilla e saj kishte një kontinuitet të pandërprerë, gjithnjë duke e ruajtur karakterin e saj autokton dhe si e tillë nuk ishte përhapur tek kulturat fqinje⁴.

Në ndërtimin e arkitekturës tradicionale të Kosovës, e cila është trashëgimi e çmuar, kanë ndikuar rrethana të ndryshme politike, gjeografike, kulturore si dhe njohuritë në teknikat e ndërtimit, por gjithmonë është ruajtur karakteri i saj i rrënjës.

Andaj, edhe dokumentimi dhe ruajtja e objekteve arkitektonike të një kombi ka një rëndësi shumë të madhe në krijimin e identitetit kombëtar.

Dokumentimi i objekteve arkitektonike tradicionale nënkupton mbledhjen e të dhënave grafike dhe tekstuale të një ndërtese për të krijuar një ide rreth hapësirës së ndërtesës dhe ndërlidhjen e saj me rrethinën. Si rrjedhojë, kjo u lehtëson vrojtuesve që të kuptojnë kontekstin historik, kulturor dhe shoqëror të këtyre vendbanimeve përgjatë shekujve. Gjithashtu, dokumentimi i tyre ndihmon në fazën e restaurimit dhe konservimit të ndërtesave.⁵ Për më tepër, duke filluar nga dokumentimi i cili do të shpie drejt ruajtjes, do të mund të bëhet promovimi i këtyre objekteve me vlerë të veçantë për trashëgiminë kulturore të Kosovës.

³ Ulusoy, M., & Kuyrukcu, E.Y. (2012). The meaning and importance of the traditional architecture in architecture education; Gönen winter school model. *Procedia – Social and Behavioural Sciences* 47, 220-2126.

⁴ Doli, F. (2009). *Arkitektura Vernakulare e Kosovës*, Prishtinë

⁵ CHWB Kosovo (2010). *Arkitektura Tradicionale dhe Metodat e Dokumentimit*. Qasur nga http://chwb.org/kosovo/wp-content/uploads/sites/3/2014/07/Publication_2010_6.pdf

Qëllimi i punimit

Qëllimi primar i këtij hulumtimi është të analizojë historinë, dokumentimin dhe ruajtjen e objekteve me arkitekturë tradicionale në Kosovë, si dhe të ngrit vetëdijen për ruajtjen, dokumentimin dhe promovimin e këtyre objekteve. Kjo gjendje e rënduar edhe trajtimi joadekuat si dhe vandalizmat tjerë që vazhdojnë edhe sot e kësaj dite. Andaj, qëllimi i këtij punimi është që të ngritet vetëdija për rëndësinë e ruajtjes së trashëgimisë kulturore, për më tepër të arkitekturës tradicionale. Qëllimi dytësorë është të analizojë ligjet për ruajtjen dhe restaurimin e monumenteve tradicionale në Kosovë, dhe sa po zbatohet ky ligj bazuar në gjendjen aktuale të monumenteve të përfshira në hulumtim.

Metodologjia e hulumtimit

Ky hulumtim është kualitativ dhe eksplorues ku do të studioen aspektet teorike të arkitekturës tradicionale në Kosovë. Për të arritur këtë qëllim do të përdoret literaturë e pasur vendore dhe ndërkombëtare e cila trajton problematikën emarrë në shqyrtim. Për më tepër, do të hulumtohet arkiva e Kosovës për të parë se a janë të dokumentuara objektet të cilat janë objekt studimi në këtë hulumtim.

Pyetjet e hulumtimit janë:

A ka dokumentacion të mjaftueshëm të objekteve arkitektonike tradicionale në arkivën e Kosovës?

A është ruajtja e këtyre objekteve e rregulluar me ligj dhe sa zbatohet ky ligj?

A ka ndonjë fond dhe sa investohet në ruajtjen e këtyre objekteve nga qeveria e Kosovës?

Rezultatet e pritura nga ky punim lidhen me pyetjen “Sa i rëndësishm është dokumentimi dhe ruajtja e arkitekturës tradicionale në ruajtjen e vlerave të një shteti?”

KAPITULLI I

VËSHTRIM MBI TRASHËGIMINË KULTUTORE NË KOSOVË

1.1. Trashëgimia kulturore në Kosovë

Arkitektura tradicionale është trashëgimi e çmuar e Kosovës, në ndërtimin e të cilës kanë ndikuar rrethana të ndryshme politike, gjeografike, kulturore si dhe njohuritë për teknikat e ndërtimit. Në përgjithësi, arkitektura e popullit shqiptar karakterizohet me vazhdimësi të pandërprerë dhe përfshirë gjini të ndryshme ndërtuar nga mjeshtër anonim shqiptarë të cilët krijuan vlera të lara arkitektonike⁶. Në Kosovë, kjo arkitekturë më së shumti paraqitet përmes shtëpisë së vjetër fshatare dhe qytetare, që thuhet se i përket arkitekturës që mbretëronte në pjesën më të madhe të Gadishullit Ballkanik dhe në një pjesë të Azisë së Vogël, por këto shtëpi ishin ndërtuar me tipare autoktone, origjinale dhe unike⁷. Në hulumtimin e tij, Doli (2009) kishte analizuar me hollësi zhvillimin e një numri të objekteve arkitektonike që nga lashtësia parahistorike e deri në ditët tona. Ndër këto objekte janë kullat shqiptare, oda e burrave, hambari, koshi, të cilat kanë karakter vernakular autokton, dhe shumë kompleks. Për më tepër, ai kishte analizuar edhe objektet etnografike të luajtshme, magjen, djepin dhe arkën si dhe ornametikën e aplikuar në objektet e arkitekturës vernakulare shiptare. Për të gjitha këto do të flasim më gjerësisht në nën kapitullin për llojet e objekteve të arkitekturës tradicionale në Kosovë. Përveç objekteve arkitektonike, në Kosovë ka edhe koleksione të artefakteve të fushave të ndryshme si: artistike, zejtare, arkaike e fetare, materiale dhe shpirtërore.

*“Të ngarkuara me një mesazh shpirtëror të së kaluarës, veprat monumentale të popujve janë në kohën tonë dëshmi e gjallë e traditave të tyre shekullore. Njerëzimi, që çdo ditë bëhet i ndërgjegjshëm për unitetin e vlerave njerëzore, i konsideron ato si pasuri të përbashkët dhe përballë brezave të ardhshëm është bashkërisht përgjegjës për ruajtjes e tyre. Ai duhet që këtë pasuri këtëyre brezave t’ua transmetojë me gjithë pasurinë dhe vërtetësië e saj”.*⁸

⁶ Doli, F. (2009). *Arkitektura Vernakulare e Kosovës*. Prishtinë.

⁷ *Ibid*

⁸ *Ibid*, fq. 17

Ashtu siç mund të shohim nga observimet e Dolit (2018) lidhur me rëndësinë e veprave monumentale, mund të themi se dokumentimi dhe ruajtja e objekteve arkitektonike ka një rëndësi shumë të madhe në ruajtjen e historisë së një kombi. Si pasojë e okupatorëve dhe luftërave të ndryshme që kanë ndodhur në trojet shqiptare, shumë nga objektet tradicionale janë dëmtuar apo shkatërruar fare. Sidomos lufta e fundit në Kosovë e ka rënduar edhe më tepër këtë gjendje, mirëpo me ndihmën e organizatave ndërkombëtare në vitin 1999 filloi edhe kampanja e restaurimit të tyre. Sipas Osmanit (2003), sikur të bëheshin gjurmime arkeologjike, gati në çdo lokalitet do të haseshin mbeturina që dëshmojnë se kanë ekzistuar vendbanime të cilat si pasojë e luftërave apo epidemive të ndryshme, shumë prej tyre janë rrënuar apo braktisur, dhe pastaj janë rimëkëmbuar apo edhe janë ndërtuar vendbanime të reja.⁹ Megjithatë, thuhet se Prishtina ka qenë shumë e bukur, me shumë shtëpi dhe ndërtesa të bukura të cilat regjimi i dikurshëm Jugosllav rreth vitit 1980 rrënoi pjesën e vjetër të qytetit, duke shkatërruar kështu shtëpitë prej druri të cilat kishin qenë të vjetra edhe nga treqind vjet, dhe në vendin e tyre ndërtoi shtëpi të stilit socialist.¹⁰

Me definimin e Statusit të Kosovës si shtet i pavarur demokratik, ruajtja e trashëgimisë kulturore është një nga kërkesat kryesore. Komunitetet lokale duhet të kanë ndjenjën e pronësisë së trashëgimisë së tyre. Është thelbësore që trashëgimia kulturore të shihet brenda kontekstit të të drejtave njerëzore dhe si pjesë e përpjekjeve të njerëzve për ruajtje të identitetit të tyre dhe përmes kësaj edhe diverzitetin kulturor në botë. Mirëpo, hapi i parë drejt arritjes së këtij qëllimi është eksplorimi i objekteve të arkitekturës tradicionale në Kosovë dhe dokumentimi i tyre. Duhet të ngritet vetëdija e qytetarëve, si në nivelin lokal edhe në atë komunal dhe shtetëror, për rëndësinë e ruajtjes së trashëgimisë kulturore të trashëguar nga të parët tanë.

1.2. Historiku i shkurtër i Republikës së Kosovës

Kosova është shteti më i ri në Evropë i cili e ka shpallur pavarësinë në vitin 2008. Shtrihet në një sipërfaqe prej 10.887 m², dhe ka pozitë qendrore gjeografike të Siujdhesës Ballkanike. Kufizohet me Shqipërinë, Malin e Zi, Serbinë dhe Maqedoninë Veriore. Hulumtues të ndryshëm tregojnë që populli Kosovar ka një histori të gjatë vuajtjesh. Në vitin 1989, Kosova e humbi autonominë e saj si pjesë e ish Jugosllavisë, dhe për dhjetë vite pati një sistem ku qeveria udhëhiqej

⁹ Osmani, J. (2003). *Vendbanimet e Kosovës, Prishtina, Kasrtioti dhe Fushë Kosova*. Prishtinë, Shkrola.

¹⁰ Sieckmeyer, D., & Sieckmeyer J. (2010). *Kosova – Kosovo: NewBorn*, Seltman+Sohne, Koln.

më së shumti nga Serbia. Si pasojë, gjatë viteve të 90-ta u bojkotuan institucionet zyrtare dhe u krijua sistemi paralel. Dhuna ndaj kosovarëve rritej çdo ditë e më shumë, kryheshin vrasje të shumta dhe i tërë vendi ishte nën masat e rrepta të orës policore¹¹. Gjatë vitit 1998 u krijua edhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës si rezistencë ndaj dhunës serbe që po ju bëhej shqiptarëve Kosovarë gjatë asaj kohe.

Nga shkurti i vitit 1998 deri në intervenimin e NATO-s në vitin 1999, konflikti mes Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe forcave serbe në Kosovë rezultoi me largimin e 300,000 civilëve nga shtëpitë e tyre, përfshirë gra dhe fëmijë, si dhe vrasjen e mbi 1500 Kosovarëve. Këto krime bënë që NATO të fillojë ofensivën. Edhe gjatë bombardimeve të NATO-s, serbët vazhdonin të vrisnin dhe shkatërronin shtëpi apo monumenta tjera tradicionale në Kosovë, dhe sipas burimeve të NATO-s, gati një milion qytetarë e lëshuan Kosovën (Roberts, 1999). Bombardimet ajrore të NATO-s zgjatën nga 24 marsi 1999 deri më 10 qershor 1999.

Faktet tregojnë se përveç viktimave të shumta, serbet kanë shkatërruar, plaçkitur, dhe djegur shumë pasuri të qytetarëve. Janë raportuar mbi 500 fshatra të djegura, janë djegur objekte të shumta biznesi, është bërë vrasje e bagëti, duke mos lënë anash këtu edhe objektet fetare, e ne veçanti xhamitë dhe objektet tjera me rëndësi historike e shoqërore në Kosovë.¹²

1.3. Objektet tradicionale dhe rëndësia e tyre

Shumë studiues kanë folur për nocionin “arkitekturë tradicionale,” çfarë nënkuptojmë me të? Sipas Wells (1986), hulumtues të ndryshëm kanë dhënë definicione të ndryshme dhe disa janë besnik ndaj asaj se objektet tradicionale “duhet të janë të vjetra, rurale, struktura tradicionale të formave dhe materialeve të ndërtuara me dorë për përdorim të brendshëm apo agrokulturore”.¹³ Për më tepër, arkitektura tradicionale e një vendi ndërlidhet me faktorë të ndryshëm, për të përmendur disa si: traditat, pushtuesit, dhe kushtet klimatike. Kur flasim për rëndësinë e arkitekturës tradicionale, Rodriguez dhe Pettus argumentojnë se arkitektura tradicionale është një pasqyrim i përvojave historike dhe identitetin kulturor të vet krijuesve, dhe se ata [vet krijuesit] e kanë të drejtën të ndërtojnë duke u bazuar në kulturën, historinë dhe ambientin e tyre¹⁴.

¹¹ Krasniqi, J. (2006). *Kthesa e Madhe: Ushtria Çlirimtare e Kosovës*, Prishtinë: Buzuku.

¹² KIPRED (2005). *Leksionet e mesuara: Komisioni i Pavarur Ndërkombëtar për Kosovën*. Oxford University Press.

¹³ Wells, C. (1986). Old claims and new demands: Vernacular architecture studies today. *Perspectives in Vernacular Architecture*, 2(1), 1-10, p.1.

¹⁴ Rodriguez, A. & Pettus, K. (1990). *The importance of vernacular traditions*. JSTOR, 22(3), 2-4.

Dokumentimi i objekteve arkitektonike tradicionale nënkupton mbledhjen e të dhënave grafike dhe tekstuale të një ndërtese për të krijuar një ide rreth hapësirës së ndërtesës dhe ndërlidhjen e saj me rrethinën. Si rrjedhojë, kjo u lehtëson vrojtuesve që të kuptojnë kontekstin historik, kulturor dhe shoqëror të këtyre vendbanimeve përgjatë shekujve. Gjithashtu, dokumentimi i tyre ndihmon në fazën e restaurimit dhe konservimit të ndërtesave.¹⁵ Për më tepër, duke filluar nga dokumentimi i cili do të shpie drejt ruajtjes, do të mund të bëhet promovimi i këtyre objekteve me vlerë të veçantë për trashëgiminë kulturore të Kosovës.

Trashëgimia kulturore historike e një populli paraqet tërësinë e vlerave shpirtërore dhe material të krijuara përgjatë historisë së tij, pasqyron zhvillimin ekonomik, shoqëror, politik, fetar e kulturor në të kaluarën e tij, paraqet luftën e tij shekullore për ruajtjen e identitetit të tij etnik, gjuhësor dhe kulturor. Trashëgimia kulturore përfshin kulturën të prekshme si ndërtesat, monumente, peizazhe, librat, veprat e artit, dhe objekte, kultura e paprekshme të tilla si folklori, veshjet, traditat, gjuha, dhe dije, dhe trashëgimisë natyrore përfshirë edhe peisazhet kulturore-të rëndësishme. Ruajtja e trashëgimisë kulturore në të kaluarën është parë nga industria e profesionistëve vetëm si një çështje teknike ku përdorshin praktikat më të mira apo më të reja për ruajtjen e artefakteve apo monumenteve. Mirëpo ka pasur një ndryshim të paradigmës dhe në nivelin global, UNESCO është organizata udhëheqëse e cila së bashku me angazhimin e vendeve anëtare ka për qëllim ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe diverzitetit kulturor. Që nga konferenca e Amsterdimit e vitit 2003, UNESCO, përveç intervenimeve të qeverive dhe profesionistëve, ka promovuar edhe përfshirjen e komuniteteve locale në ruajtjen e trashëgimisë kulturore.¹⁶

1.4. Historiku i shkurtër i qytetit të Prishtinës

Sipas të dhënave të Komunës së Prishtinës, Prishtina ka një pozitë të përshtatshme gjeografike me 48 fshatra dhe sipërfaqe prej 572 km². Si kryeqytet i Kosovës që është, në Prishtinë

¹⁵ CHWB Kosovo (2010). *Arkitektura Tradicionale dhe Metodat e Dokumentimit*. Qasur nga http://chwb.org/kosovo/ep-content/uploads/sites/3/2014/07/Publication_2010_6.pdf

¹⁶ UNESCO (2004) *Cultural Heritage in South-East Europe: Kosovo. Cultural heritage in Kosovo. Protection and Conservation of a multi-ethnic heritage in danger*. 1-13.

përveç shumicës shqiptare jetojnë edhe komunitetet tjera si serb, turk, boshnjak, rom, ashkali, etj. Që nga viti 1981 në Kosovë nuk ka pasur regjistrim të popullsisë, mirëpo vërehet një shtim i lartë i popullsisë në Prishtinë ku mendohet se numri i banorëve është 400 mijë.¹⁷

Hulumtimet tregojnë se në Prishtinë ka pasur shumë ndërtesa të vjetra me vlera kulturore, ku vetëm në qendrën e qytetit kishte ekzistuar çarshia me mbi 300 dyqane. Mirëpo që nga viti 1945 ka pasur shumë shkatërrime si rezultat i politikave të ndryshme joliberalë ku qëllimi ishte të shkatërrohen të vjetrat për t'u ndëruar të reja.¹⁸ Nga hulumtimi ynë mund të vërehet që shumë objekte kanë vazhduar të rrenohen deri në ditët e sotme, dhe kjo si pasojë e luftërave të ndryshme, mos mirëmbajtjes apo planeve për të ndërtuar objekte të reja.

1.5. Llojet e objekteve të arkitekturës tradicionale në Kosovë

Kosova ka një trashëgimi të pasur kulturore dhe tradicionale, si: veshjet tradicionale, artizanate të ndryshme, si dhe trashëgimi kulturore ku hyjnë objektet e ndryshme të jetesës apo fetare. Në fund të shekullit XIX dhe tërë shekullin XX, sipas Stubllës (2007), në Kosovë kishte mjaft lloje të ndryshme të objekteve të vendbanimeve, nga më të thjeshtat deri në ato më moderne. Disa nga llojet e objekteve të ndërtuara gjatë periudhave të ndryshme kohore në Kosovë ishin: stanet, kasollet, plisaret, shtëpitë përdhesë, shtëpitë në kat me çardak, kullat, kishat dhe xhamiat, hamamet, hanet, kështjellat, kalatë, tyrbet, etj. Bazuar në burimet e mbledhura nga Stublla (2007) do të japim disa informata për objektet e banuar nga shqiptarët në Kosovë si: stanet, kasollet, plisaret, shtëpitë përdhesë, shtëpitë në kat me çardak dhe kullat.¹⁹

Stanet ishin shtëpi të thjeshta të banimit të ndërtuara tërësisht nga druri dhe dyshemeja ishte tokë e thatë dhe e ngjeshur mirë. Kasollja, si objekt tjetër për jetesë, ishte poashtu e thjeshtë. Në fillim ato ndërtoheshin me thupra të thurura ndërsa më vonë me qerpiçë dhe përbrenda lyhej me baltë. Plisarja ishte lloj i kasolles në trajtë të rrumbullakët apo të konit dhe e ndëruar nga plisat e dheut të barit më rrënjë dhe me skelet prej drurit. Shtëpitë përdhesë ndërtoheshin nga pllazinave të ngritura në trajtë skeleti me shtylla të gozhdura dhe muri lyhej me baltë të përzier me byl, e

¹⁷ Komuna e Prishtinës, Republika e Kosovës. <https://kk.rks-gov.net/prishtine/qyteti/lidhjet-ne-web/>

¹⁸ IKS, (2006). *Një e ardhme për të kaluarën e Prishtinës*, Prishtinë.

¹⁹ Stublla, Sh. (2007). *Mbiejtësia, Aspekti muzeor*. Prishtinë, CIP.

pastaj përmbi me gëlçere. Shtëpitë në kat me çardak ishin me thupra e pllazina dhe e lyer vetëm përbrenda. Kjo shtëpi ishte e ngjajshme me atë përdhësë, mirëpo kishte dhe një kat më lartë. Kullat në anën tjetër njiheshin si “fortifikatë qëndrese dhe nderi, po ashtu edhe simbol mbijetese,”²⁰ Kullat shqiptare janë dëshmi të arkitekturës së vjetër shqiptare dhe ato përdorshin për vendbanim, pritje të mysafirëve, për mbrojtje, për identitet kombëtar, etj.

Xhamitë, funksionin primar i të cilave është si faltore apo si vend ku kryhen ritualet tjera fetare si ai i faljes, në trojet shqiptare janë ndërtuar që nga fillimi i pushtimit Osman.²¹ Mirëpo, sipas Krasniqit (2017), historikisht ato kanë qenë institucion themelor islam ku ka qenë e lidhur jeta fetare, arsimore, edukative, kulturne, politike e shoqërore e myslimanëve. Në Kosovë ka një numër të madh të xhamive të vjetra të ndërtuara gjatë periudhës osmane si dhe shumë të tjera të ndërtuara ndër vite, e edhe ditëve të sotme ky numër vazhdon të rritet.

Edhe **teqetë** kishin funksion të ngjajshëm, fetar dhe edukativo arsimor, ku e veçanta e arsimit dhe edukimit në teqe ka qenë mësimi dhe komentimi i artit dhe letërsisë së tesavusit.²²

Kishat, gjithashtu funksionin primar e kanë të shërbejnë si objekte për kryerjen e ritualeve fetare. Sipas UNESCO, kishat mesjetare të cilat gjenden në Kosovë dhe pasqyrojnë kulturën bizantino-romane të zhvilluar gjatë shekujve 13-të dhe 17-të janë: Manastiri i Deçanit, Manastiri i Pejës, Kisha e Apostujve të shenjtë, dhe Kisha e Shën Ljevisës.

Hanet, një lloj objekti vend strehues të udhëtarëve i ngjajshëm për nga funksioni me motelet dhe hotelet e kohës sonë. Përhapja e tyre, kryesisht ishte nëpër qendrat urbane dhe në mes tyre. Një numër i tyre, në rrafshin e Dukagjinit janë mirëmbajtur të plota apo fragmente të tyre që janë adoptuar dhe kryesisht zhvillojnë veprimtari gastronomie.

Hamamet, një lloj objekti që shërbente si banjo publike e kohës së perandoris osmane, po ashtu në Kosovë kanë qenë të përhapura nëpër qendra urbane të asaj kohe.^[1] Hameme të tëra, apo fragmente të tyre edhe sot janë në funksion gjegjësisht mirëmbahen. Deri më tashti në këtë enciklopedi janë bërë përshkrime të disa prej tyre. Ndër to dallohet Hamami i Haxhi Beut në Pejë.

Kështjella si formë më e hershme e urbanizimit që për shkaqe të ndryshme të historis kanë mbetur pa u plotësuar me objektet përkatëse përreth, duket të ketë në Kosovë, mirpo gjurmimet

²⁰ Stublla, Sh. (2007). *Mbiejtësa, Aspekti muzeor*. Prishtinë, CIP, 404.

²¹ Krasniqi, N. (2017). *Zhvillimi i Kulturës Shqiptare me Ndikime Orientale Prej Shekullit XVIII deri në Fillimet e Rilindjes Komëtare*. Instituti Albanologjik, Prishtinë.

²² *Ibid.*

arkeologjike ende janë në fazën e fëmijërisë. Si rezultat i kësaj faze është bërë publik edhe gjetja e një Kështjelle të kohës romake, Kështjella e Harilaqit, 25 kilometra në perendim të Prishtinës.

Kalatë përpos Kalasë së Prizrenit, fragmentet e së cilës japin kuartë edhe për vëzhguesin e rastit muret e Kalas, janë gjetur edhe copa fragmentesh të Kalasë së Pogradit dhe të Kalasë Ogurzeze apo të njohur edhe nën emërtimin Kalaja e Mitrovicës. Kalaja e Prizrenit ishte ndërtuar nga Osmanët në vitin 1453 dhe në mesin e çatave gjenden 28 minare.

Kulla shqiptare është ndërtim autokton që nuk mund ta gjejmë gjetkë. Kulla është në kuadër të arkitekturës popullore autoktone dhe ndërtimi i saj e ka zanafillën qysh në lashtësinë parahistorike e deri në kohët moderne kur edhe arriti formësim arkitektonik dhe kompozicional. Në veçanti, kulla e tipit të Rrafshit të Dukagjinit është një pasuri e cila i kontribon thesarit të kulturës materiale gjithëbotërore. Varësisht nga kompozicioni i dyshemesë, dhe strukturës hapësinore të kullës është bërë edhe kategorizimi i tipeve të ndryshme të kullave me dyshekllëk të drunjte dhe të gurtë.




Figura 1 - Dukja perspektive e “kullës me karollhane”, fshati Popaj, Malësi e Gjakovës.²³

Kulla apo konaku i Sadik Ramadan Shehut ishte 350 vjet e vjetër. Përveq rëndësisë së paraqitjes së vlerave tradicionale, në këtë shtëpi ishte përgatitur shpallja e pavarsisë së Shqipërisë në vitin 1912. Mirëpo, fatkeqësisht si shumë monumente me vlerë të madhe kulturore në Kosovë, edhe kjo kala ishte shkatërruar nga serbët (Sieckmeyer & Sieckmeyer, 2010).

²³ Marrë nga Flamur Doli, *Arkitektura Vernakulare e Kosovës*, 2009, f. 195.

Si element i rëndësishëm dhe i njohur në kullës ishte ‘**oda e burrave**’ e cila paraqitet si ‘një konstantë arkitektonike formësuese’²⁴. Oda e burrave është një konstancë e cila është ruajtur dhe zbatuar gjithnjë gjatë evoluimit të shtëpisë, që nga koha e neolitit e deri në fillim të shekullit tonë.

Hambari dhe **Koshi** si dy forma të drithnikëve kishin karakter autokton dhe shumë kompleks të cilat kishin fill ndërtimor me karakter religjioz. Këta drithnikë përdorshin për të ruajtur bukën dhe ishin të zbukuruar me ornamente simbolike të kulteve të ndryshme, e në këtë rast kultit të bukës, sigurimi i të cilës ishte problem qenësor në të kaluarën. Këto dukuri me karakter religjios u ruajtën që nga koha e pellazgëve e deri në ditët tona Hambari, si formë e drithnikut, ka një përmbajtje hapësinore arkitektonike të ngjajshme me ato të megaronit. Megaronët ishin tempuj parahistorik, shtëpi banimi që nga kultura e neolitit. **Hambari** kishte disa ndarje, 6 hapësira për ruajtjen e grurit dhe miellit, të cilat quheshin ‘presek’. Ishte i ndërtuar prej strukturave arkitektonike të drunjta, shtyllat vertikale dhe trarët ishin prej druri, ndërsa çatia ishte e mbuluar me kashtë. Në ballinën e hambarit, në të dyja anët, paraqitet ornament i me stilizim abstrakt gjeometrik nga kulti i gjarprit, që në mitologjinë shqiptare gjarpri simbolizonte rojën e templullit. Edhe kulti i diellit ishte përdorur si ornamentikë simbolike në hambarë, dhe dielli në mitologjinë shqiptare trajtohet si sibol i jetës, shëndetit, mirëqenies dhe prodhimit. Dhe kështu, këto dy kulte përdorshin në funksionin e mbrojtjes së mirëqenies²⁵.

²⁴ Marrë nga Doli, F. (2009). *Arkitektura Vernakulare e Kosovës*, Prishtinë.

²⁵ Ibid.



Figura 2 - Dukja perspektive e hambarit karakteristik, ndërtuar në kompleksin jashtëzakonisht të zhvilluar të teqesë Harabati në Tetovë.²⁶

Kjo formë e zbukurimit gjeometrik ishte përdorur edhe për zbukurimin magjes, arkës dhe djepit.

Edhe **koshi**, për nga struktura konstruktive formësese ka mbijetuar që nga koha e neolitit. Fasada ballore e koshit kishte sje strukturim kompozicional me simetri të përkryer. Në brendi të koshit, poashtu shohim ornamentet e kultit të Diellit dhe ornamentin gjeometrik të sajuar nga një drejtëkëndësh dhe romboid i brendashkruar në të. **Magjja** ishte e ndërtuar në formë të arkës dhe e kishte funksionin e ruajtjes dhe ngjeshjes së brumit për bukë. Ishte e ndëruar tërësisht nga druri dhe kishte ornamente gjeometrike nga kulti i Diellit. **Arka** ishte orendi e luajtshme e cila shërbente për ruajtjes e rrobave dhe pajës së nuses, gjërave me vlerë dhe gjësendeve tjera. Kishte arka qytetare dhe fshatare. Arka ishte e ndërtuar nga druri, dhe zbukurimorja e këtij objekti shquhej për rendin ekskluziv gjeometrik dhe rendin e saj bimësor në ballinën e saj. Për më tepër, ornamentin e saj zbukurues ishte në formë të dy trekëndshave të vijëzuar²⁷.

Edhe **djepi**, si orendi e luajtshme i përket llojit të orendive të lashta popullore shqiptare. Ka lloje të ndryshme të djepit varësisht nga funksioni që kishin: për bartjen e fëmijës apo për përkundje dhe shlodhje të fëmijës, si dhe djepi fshatar dhe qytetar. Ornamentika që paraqitet tek djepat ishte

²⁶ Marrë nga Doli, F. (2009). *Arkitektura Vernaulare e Kosovës*, Prishtinë, fq. 270.

²⁷ Marrë nga Doli, F. (2009). *Arkitektura Vernaulare e Kosovës*, Prishtinë.

geometrike me funksion estetik dhe mbrojtës. Edhe djepi punohej nga elementet e durnjta të përgatitura dhe të ngërthyera mes vete me kunjat përkatës, plotësisht nga druri.




Figura 3 - Magje tipike, rrethina e Mitrovicës, daltuar me ornamente kultike dhe zbukuruese në gjithë ballin e saj.²⁸



Figura 4 - Djepi me ornamentikë zbukurimore të karakterit të kombinuar: gjeometrik dhe imësor.²⁹

Objekte tjera interesante në brendinë e tyre, por që nuk bien në sy për kalimtarin e rastit, janë dhe **Tyrbet**, një lloj godine mbi varrin e personave kryesisht shpirtërorë, por që ka edhe të till që nuk kanë të bëjnë me anën fetare të shoqërisë. Tyrbja e Sulltan Muratit në rrugën Prishtinë-Vushtrri është ndërtesa më e vjetër osmane në botë. Brenda saj janë vendosur organet e brendshme të sulltanit ndërsa eshtrat e tij janë dërguar në Turqi (Sieckmeyer & Sieckmeyer, 2010).

Objekte të stilit të kohës **austro-hungareze** janë të pakta dhe kryesisht nëpër qendra si Prishtina, Mitrovica dhe Peja. Ndër to dallohet godina pranë godinës së Teatrit Kombëtar në Prishtinë dhe hoteli Metohia në Pejë.

Objekte të stilit të kohës **komuniste** janë objektet më të përhapura. Kjo si shkak i sistemit të pas luftës së dytë botërore. Objektet e tilla janë kryesisht nga betoni, me dekorime të mangëta, dhe kryesisht të ndërtuara për qëllime zbatueshmërie. Gjatë kësaj kohe vërehte një formë tjetër e shprehjes së artit nëpërmjet "Lapidareve", "Përmendore" "Statujave", "Busteve" të ngritura kushtuar luftëtarëve dhe figurave të shquara të sistemit komunist, ndër të cilat dominon figura e Titos, figurat e rilindjes kombëtare shqiptare pranë objekteve shkollore krahas atyre komuniste. Ndër objekte të këtilla të njohura është Përmendorja e Vëllaznim Bashkimit në Prishtinë, Lapidari i "Boro Ramizit" në Landrovicë.

²⁸ Marrë nga Doli, F. (2009). *Arkitektura Vernakulare e Kosovës*, Prishtinë, f. 333.

Objekte të stilit të "pas luftës" së fundit, janë kryesisht objekte jo aq të larta si në stilin komunist, mesatarja e lartësisë së objekteve të larta arrin 5-6 katë. Në mjete të informimit propagandohet ndërtime të kullave të larta me objekte përreth që si tërsi formojnë kështjella moderne të cilat shërbejnë edhe si vendbanimi, vendstrehimi por para së gjithash si vende të zyreve të financave përreth së cilave shtrihen objekte tregtare. Si do që të jetë, për një zgjim të artit të ndërtimitaris edhe përkundër ndërtimeve të shumta nuk mund të flitet. Në anën tjetër, ngritja e monumenteve të stilit komunistë, është bërë si pjesë e traditës. Si duket kjo traditë e ka zëvendësuar rolin e tyrbeve.

Duke pasur shtrirje në Evropën jug-lindore, arkitektura në Kosovë është e ngjajshme me atë në regjion sa i përket teknikave të ndërtimit, përdorimit të materialeve si dhe shprehjes arkitektonike. Luftërat e shumta dhe sundimet nga popul të ndryshëm gjithashtu kanë pasur mjaft ndikim në ndërtimin, dokumentimin dhe ruajtjen e këtyre objekteve. Ligji Nr. 02/L-88 për Trashëgiminë kulturore e rregullon ruajtjen e ndërtesave urbane apo rurale të dalluara për nga vlerat historike, arkeologjike, artistike, shkencore, me interes shoqëror si dhe inventarizimin, dokumentimin dhe mbrojtjen e përkohshme të tyre.³⁰ Megjithatë, hulumtimet përkatëse tregojnë se këto objekte të arkitekturës tradicionale në Kosovë janë në gjendje jo të mire dhe për to nuk ka dokumentacion të mjaftueshëm.

Sipas raportit të UNESCO-s dalë nga analizat e bëra në Kosovë në vitin 2004, thuhet se trashëgimia e Kosovës përbëhet nga tri kategori kryesore të arkitekturës: arkitektura islamike - gjamitë; Arkitektura bizantino-ortodokse ku përfshihen kishat dhe manastiret, si dhe Arkitektura tradicionale (vernakulare) ku përfshihen objektet e banimit si: kullat, konaqet, urat, kalatë dhe qendrat urbane.³¹ Mirëpo, për qëllime të këtij hulumtimi ne do të analizojmë vetëm arkitekturën tradicionale – vernakulare (objektet e banimit). Për më tepër, sipas këtij hulumtimi, gjendja e këtyre objekteve është mjaft e keqe si rezultat i shkatërrimit me dinamit, bombardimit me artileri dhe zjarrë, si pasojë e vandalizmave të ndryshëm dhe grabitjeve, si dhe si pasojë e procesit normal të vjetërimit apo si pasojë e ndotjes së ambientit dhe neglizhencës për t'i mbrojtur dhe ruajtur ato.³²

³⁰ Ligji për trashëgiminë kulturore 2008, Ligji Nr. 02/L-88. Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Prishtinë: Viti III/Nr. 29/o1 korrik 2008. Qasur nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2533>

³¹ UNESCO (2004) Cultural Heritage in South-East Europe: Kosovo. Cultural heritage in Kosovo. Protection and Conservation of a multi-ethnic heritage in danger. 1-13.

³² *Ibid.*

Shumë objekte të vjetra në Kosovë janë dëmtuar apo janë djegur tërësisht gjatë luftës së fundit në Kosovë, përfshirë këtu shtëpi privatë të banimit, pazare si ai i Gjakovës, Vushtrrisë dhe Pejës, shumë xhami e kisha, si dhe më shumë se 500 kulla.³³

Hulumtime tregojnë se instituti për mbrojtjen e monumenteve kulturore të Kosovës ishte themeluar në vitin 1956 dhe trajtimi i objekteve fetare ishte diskriminues. Deri para luftës së fundit rreth 210 kisha ortodokse serbe, manastire dhe varreza ishin paraqitur si monumente të mbrojtura historike, ndërsa në anën tjetër vetëm pesëmbëdhjetë xhami nga më shumë se 600 xhami sa ishin në Kosovë, ishin paraqitur si monumente historike, edhe pse më shumë se gjysma e tyre ishin nga koha e perandorisë osmane.³⁴ Si rezultat, vetëm për monumentet e paraqitura si historike ishin dhënë fonde për restaurim, ndërsa restaurimi apo renovimi i atyre që nuk ishin të paraqitura zakonisht kishte rezultuar në dëmtimin apo dekonstruimin e elementeve origjinale arkitektonike. Për më tepër, gjatë luftës së fundit në Kosovë, si objekt primar i shkatërrimit të forcave paramilitare serbe ishin shkatërrimi i xhamive, ku së paku 207 nga rreth 609 kisha sa ishin në Kosovë ishin dëmtuar apo shkatëruar komplet.³⁵




Figura 5 - Çarshia e vjetër e qytetit të Pejës, para luftës së fundit në Kosovë.³⁶

³³ Herscher, A., & Riedlmayer, A. (2000). Monument and Crime: The Destruction of Historic Architecture in Kosovo. *Grey Room*, (1), 108-122.

³⁴ *Ibid.*

³⁵ *Ibid.*

³⁶ E huazuar nga interneti me datën: 09/11/2019, në:

<https://www.facebook.com/photo.php?fbid=10217715547265167&set=pcb.2142768242421359&type=3&theater>



Figura 6 - Çarshia e re e qytetit të Pejës³⁷

Në Figurën 5 është paraqitur çarshia e vjetër në Pejë e cila gjatë luftës së fundit është djegur plotësisht, ndërsa në figurën 6 mund të shohim si duket ajo në ditët e sotme, dhe si ndërtuesit e saj janë munduar të ruajnë pamjen e njëjtë.



Figura 7 - Qarshia e vjetër e Gjakovës, para luftës së fundit në Kosovë.³⁸

³⁷ Foto e huazuar nga internet me datën: 09/11/2019, në <https://ndertimi.info/carshia-e-pejes-si-vend-i-komunikimit-dhe-gender-tregtare/>

³⁸ Foto e huazuar nga internet me datën: 09/11/2019, në <https://kallxo.com/gjate/carshia-e-shkaterruar/>



Figura 8 - Qarshia e rrënuar në Gjakovë, gjatë luftës së fundit në Kosovë³⁹

Në figurat 7 dhe 8 mund të shohim se si ka dukej çarshia e qytetit të Gjakovës para luftës së fundit në Kosovë, dhe si dukej ajo pas shkatërrimit të saj.

1.6. Arkitektura në Kosovën e viteve të pasluftës

Ashtu si në vendet tjera të botës, edhe në Kosovë kanë ndodhur ndryshime në infrastrukturë. Në Prishtinë, në veçanti, vërehet ky ndryshim tejet i madh duke e krahasuar me vitet para luftës, para viteve të 90-ta. Siç u përmend edhe më herët, gjatë luftës janë shkatërruar dhe djegur shume objekte, çoftë ato ndërtesa private të banimit, publike apo edhe me vlerë të lartë kombëtare, kulturore apo fetare. Shumë donacione janë dhënë nga donatorë të ndryshëm por edhe individë të ndryshëm fizik nga diaspora. Mirëpo, dëmet ishin shumë të mëdha. Në hulumtimin e tij, Earnest (2015), që për qëllim kishte hulumtimin e riparimit të infrastrukturës në vendet e pasluftës, me vëmendje tek Kosova, tregon se rehabilitimi dhe rikonstruimi i infrastrukturës së shkatërruar si pasojë e luftës është një sfidë për të gjitha vendet që kalojnë luftë. Për më tepër,

³⁹ Foto e huazuar nga internet me daten: 09/11/2019, në <https://kallxo.com/gjate/carshia-e-shkaterruar/>

rezultatet nga ky hulumtim tregojnë që planifikimi dhe implementimi i projekteve të rikonstruktimit janë dëshmuar të janë shumë më sfiduese se që janë planifikuar, dhe arsyeja e adaptimit të limituar të menaxhimit të projekteve të rikonstruktimit është pasojë e ndryshimeve politike, ekonomike dhe sociale në Kosovë nga lufta e vitit 1999.⁴⁰ Kjo edhe mund të spjegojë faktin që janë bërë shumë ndërtime, e për ndërtimin e tyre mund të janë rrenuar disa të tjera më të vjetra. Në Prishtinë janë ndërtuar shumë ndërtesa të reja, përfshirë këtu edhe ndërtesën e re të Akademisë së Shkencave. Gjithashtu, në vitin 2010 është ndërtuar edhe Katedralja Nënë Tereza në qendër të Prishtinës. Mirepo, për ndërtimin e kësaj Katedraleje është rrënuar një objekt tjetër i vjetër, ish shkolla e mesme “Gjevdet Doda.” Edhe ndërtesa e ish Hotel Unionit ndërtuar në vitin 1927, ishte djegur në vitin 2009 dhe më pas u rindërtua në vitin 2013.



Figura 9 - Foto e realizuar nga Sh. Obërtinca, Shkolla e mesme Xhevdet Doda në Prishtinë⁴¹

Në figurën 9 mund të shohim objektin e vjetër të shkollës Xhevdet Doda para se të rrënohej në vitet 2006-2007 për t’u ndëruar më pas Katedralja katolike “Nënë Tereza.

⁴⁰ Earnest, J. (2015). Post-conflict reconstruction – a case study in Kosovo. *International Journal of Emergency Services*, 4(1), 103-128.

⁴¹ Foto e huazuar nga internet me datën: 09/11/2019, në <https://kallxo.com/rrefim/mesime-ne-rezistence-sistemi-paralel-arsimit-ne-kosove-ne-vitet-90/>



Figura 10 - Foto e realizuar nga U. Borova me datën: 19/9/2019, Katedralja Nënë Tereza në Prishtinë

Në planin dhe ndërtimin e objekteve të reja, çoftë ndërtesave private apo atyre publike, ndikojnë shumë faktorë. Ashtu siç e thekson Salihu (2018), edhe në organizimin dhe formësimin e banimeve tona ka ndikuar arkitektura modern, mirëpo hapësirën tonë ekzistenciale, arkitektët tanë e kanë përdorur vetëm nga aspekti gjeometrik ndërsa e kanë zhveshur nga aspektet ekzistenciale.⁴²

⁴² Astrit Salihu, *Lexim filozofik i arkitekturës*, botoi SHFK, Prishtinë, 2018, fq. 318.

Në një studim i bërë në vitin 2014 nga Hoxha et. al., mbi faktorët kulturorë që ndikojnë tek planifikuesit urban që rregullojnë hapësirën publike në Prishtinë, ku si faktorë janë marrur identiteti kombëtar, nacionalizmi etnik, konkstrukti social dhe presioni politik. Të dhënat nga ky studim kanë treguar se identiteti kombëtar është faktori kryesor që ndikon në perceptimet e planifikuesëve, pasuar nga presioni politik, ndërsa nacionalizmi etnik dhe konstrukti social janë paraqitur si më pak të rëndësishëm.⁴³ Nga këto hulumtime mund të kuptojmë se shumë faktorë ndikojnë në një popull që ka kaluar nëpër luftë dhe se tranzicioni nga lufta në paqe është shumë i vështirë. Mirëpo, lufta jonë ka ndodhur 20 vite më parë, dhe nuk duhet të lejojmë që askush të përdor këtë arsytim, por duhet të vetëdijsohemi sa më shpejtë për këtë problem dhe të ndërmarim hapat e duhur për rruajtjen dhe evidentimin e të gjitha objekteve tradicionale në Kosovë.



Figura 11 – Qyteti i Prishtinës, 2010 NewBorn.⁴⁴

Kur flet për të menduarit e arkitekturës dhe rimendimin e saj gjatë gjithë kohës, Salihu (2018) për më tepër thot se “në rimendimin e pandalshëm të saj, na shpërfaqen orientimet e

⁴³ Hoxha, V., Andrews, K.D. & Salaj, A.T. (2014). *Cultural factors affecting urban planners' intentions to regulate public space in Prishtina, Kosovo*. *Urbani izziv*, 25(2), 76-89.

⁴⁴ Sieckmeyer, D., & Sieckmeyer J. (2010). *Kosova – Kosovo*.

nryshme që më shumë i takojnë “konfuzioneve të trendit” të afirmimit të stileve të shumta, që veçojnë kryesisht formën dhe lënë anash funksionin ose programin e arkitekturës.”⁴⁵ Kjo reflektohet edhe nga ajo se çfarë mund të shohim në figurën, ndërtimet e shumta, dhe procesi i përgjithshëm i ndërtimeve në Kosovë është mjaft kaotik, përfshirë këtu edhe formën apo ndonjë plan të caktuar urbaniztik. Që nga paslufta, ndërtimet dhe procesi i ndërtimit ka degraduar vlerat kulturore dhe janë bërë transformime të shumta urbane.

⁴⁵ Astrit Salihu, *Lexim filozofik i arkitekturës*, botoi SHFK, (Prishtinë 2018), 217.

KAPITULLI I DYTË

HULUMTIMI, ANALIZA DHE GJENDJA E MONUMENTEVE TRADICINALE

2.1. Metodologjia e hulumtimit dhe analiza e evidentimit dhe gjendjes së monumenteve tradicionale në Prishtinë

Ky hulumtim është kualitativ dhe eksplorues ku do të studioen aspektet teorike të arkitekturës tradicionale në Kosovë. Për të arritur këtë qëllim do të përdoret literatura kombëtare dhe ndërkombëtare. Për më tepër, do të hulumtohet arkiva e Kosovës për të parë se a janë të dokumentuara objektet të cilat do të studiohen për qëllime të këtij hulumtimi.

Pyetjet e hulumtimit janë:

A ka dokumentacion të mjaftueshëm të objekteve arkitektonike tradicionale në arkivën e Kosovës?

A është ruajtja e këtyre objekteve e rregulluar me ligj dhe sa zbatohet ky ligj?

A ka ndonjë fond dhe sa investohet në ruajtjen e këtyre objekteve nga qeveria e Kosovës?

Rezultatet e pritura nga ky punim lidhen me pyetjen “Sa i rëndësishëm është dokumentimi dhe ruajtja e arkitekturës tradicionale në ruajtjen e vlerave të një shteti?”

Një numër i madh i objekteve arkitektonike tradicionale në Kosovë janë në gjendje të mjerueshme si pasojë e kohës, ndryshimeve klimatike, neglizhencës së autoriteve përkatëse, moskujdesit, mungesës së fondeve, ndër të tjera. Një numër i madh i tyre nuk janë i dokumentuar fare apo nuk ka dokumentacion të mjaftueshëm. Andaj hapi i parë që mund të bëhet për ruajtjen apo promovimin e këtyre objekteve është dokumentimi i tyre.

Në këtë kontekst, ky hulumtim trajton llojin e ndërtimeve në dy spektre: strukturat e ndërtimit tradicional dhe dokumentimin dhe ruajtjen e tyre. Do të ipet një përshkrim kronologjik i cili do të pasojë me shpjegim të detajuar të mënyrës së ndërtimit, dëmtimet eventuale, dokumentimit dhe ruajtjes së tyre duke u bazuar në literaturën përkatëse dhe studimin në teren. Për më tepër, do të përshkruhet artizanati dekorativ i mjeshtrit popullor. Në përfundim, punimi do të pohon rezultatet e kategorizuara dhe do të ofrojë sugjerime përkatëse të cilat do t'i adresohen rëndësisë së ruajtjes së arkitekturës tradicionale në Kosovë.

2.2. Kulla si banesë shqiptare

Për studiuesit shqiptare, kullat shqiptare si banesë dhe si fortesë apo vendbanim familjar janë vënë në pah kryesisht ne periudhën pas Luftës së II-të Botërore. Në periudhën historike, kullat si banesa, ishin shumë pak, pothuajse aspak objekt i studimit nga studiuesit shqiptarë.⁴⁶ Kërkimet, dhe hulumtimi i vlerave të ndërtimeve arkitekturore të kullave, përbejnë një bërthamë të domosdoshëm për të arritur në të vërtetën e mirëfilltë shkencore.

Nuk ka dyshim se hulumtimet arkeologjike tregojnë se trevat shqiptare përbejnë një thesar të pasur të trashëgimisë kulturore dhe materiale të zhvilluar nëpër periudha të ndryshme historike, e të cilat nga periudha në periudhë kohore, dallojnë për nga cilësia, vlerat dhe rëndësia e vetë historike. Megjithatë, disa autor sllavë shpeshherë e kontestojnë se kullat janë attribute i shqiptareve, edhe pse kulla si simbol i takon shqiptareve me shekuj.⁴⁷ Kulla si simbol i çmuar i trashëgimisë kulturore të shqiptareve është karakterizuar më modelin e ndërtimit të fortifikuar, qoftë ndërtimi i një arkitekture të ndërtimit individual, në formë të komplekseve të kullave apo një grumbull të kullave.⁴⁸ Ndër të tjera burimet material dhe objektet arkitekturore dëshmojnë një periudhë të caktuar të krijuar në rrethana të ndryshme ekonomiko-shoqërorë, politike, sociale dhe historike.

2.2.1. Dekorimet në kullat si banesa shqiptare

Kullat të cilat kanë shërbyer si banesë në të njëjtën kohë veçohen edhe për vlerat e tyre artistike në lidhje me arkitekturën fshata re. Zakonisht madhësia dhe lartësia e kullës ndryshon varësisht nga arkitektura e përzgjedhur e kullës. Ato kryesisht janë një dy apo tre katërshe, por rrallëherë edhe katërkatësh. Kulla përveç se ka shërbye si vendbanim ka krye edhe shumë funksione tjera

⁴⁶Drançolli, F. *Kulla Shqiptare* (Prishtinë, Reznici 2001), 7.

⁴⁷Beqiri, N. "Kullat Shqiptare, Djegia, Rrënimi dhe Ri Ngritja e tyre," 19 Shtator, 2013, *radiokosova e lire*.
<http://www.radiokosovaelire.com/mr-prof-nezir-beqiri-kullat-shqiptare-djegia-rrenimi-dhe-ri-ngritja-e-tyre/>

⁴⁸Toska, E & Bllaci, M., "7 Projekte të Konservimit të Integruar në Komunën e Junikut," (Prishtinë, CHwB - Trashëgimia Kulturore pa Kufij, zyra në Kosovë, 2011), 28.

duke përfshirë, por jo limituar në funksionin si odë e burrave për mysafir, luajti rolin e një institucioni me rëndësi të veçantë shoqërore, ekonomik, juridik, politik, kulturore, edukative etj.⁴⁹

Kullat janë ndërtuar me mure të jashtme veçanërisht të trasha - muret e gurit ishin rreth 1.20 më të trasha – dhe brendësia e tyre ishte bërë tërësisht prej druri dhe ishin shumë të lehta. Ky lloj i teknikës së ndërtimit siguroi forcën dhe rezistencën siç është demonstruar më së miri me ruajtjen e kullave pavarësisht nga luftërat e shpeshta dhe fatkeqësitë natyrore gjatë shekujve. Meqë brendia e tyre është prej druri, numri i dhomave dhe faqosja mund të ndryshohet me punë shumë të vogël të zdrukthëtarisë, në varësi të nevojave dhe shijes së pronarit. Kati i poshtëm normalisht përdorej si hapësirë pune, stalla të kafshëve, furra, etj; kati i parë ka hapësirën e qëndrimit gjatë ditës dhe dhomat e meshkujve dhe kati i dytë (dhe i treti nëse ka) strehon dhomat e grave dhe karakterizohet nga një sërë dritaresh të vogla që gratë mund të shohin jashtë pa u parë ose, më e rëndësishmja mund të përdoren si hapje për nxjerrjen e armëve në rast lufte⁵⁰

Atë çfarë e karakterizon kullën është se në ndërtimin e sajë është bërë me pjesëmarrjen e të gjitha shtresave klasore e shoqërore me shekuj me radhe. Ky lloj objekti apo tipi i banimit arkitektural është karakteristik vetëm tek shqiptaret dhe jo tek asnjë popull tjetër të Ballkanit. Për këtë arsye, ndërtimi me një fjalë, e marrim edhe si objekte arkitekturale: kullë-banesë e të gjitha shtresave shqiptare.⁵¹

Ky lloj ndërtimi, me një histori afro 250 vjeçare⁵², jo vetëm që ka evoluar, por ajo edhe na paraqitet në disa variante gjatë realizimit të saj disa shekullor. Njëkohësisht, vlen të theksohet, se ndërtimi i kullës, i takon një tipologjie të caktuar, por, gjatë ndërtimit në vijimësi disa elemente konstruktive-arkitektonik, si muri i dyshekllekut, galerisë nga druri etj., kanë ndryshuar vetëm në përpunimin e cilësisë së materialit të ri, si p.sh materiali nga guri.⁵³

Numri me i madh i këtyre ndërtimeve të kullave prezantohet sidomos në rrafshin e Dukagjinit (shih fig. 12, 13).

⁴⁹ Drançolli, F., *Trashëgimia Monumentale në Kosovë*, (Prishtinë, Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, 2011), 178.

⁵⁰ Fabio, M., The loss of the Kosovo cultural heritage, *Web Journal on Cultural* (2006), 28.

⁵¹ Fejaz Drançolli, *Trashëgimia Monumentale në Kosovë*, (Prishtinë: Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, 2011), 180.

⁵² Toska, B., “7 Projekte të Konservimit të Integruar në Komunën e Junikut,” 14.

⁵³ Drançolli, F., *Trashëgimia Monumentale në Kosovë*, 180.



Figura 12 - Kulla e Haxhi Zekës, Pejë.⁵⁴



Figura 13 - Kulla e Osëdutajve, Isniq (Deçan).⁵⁵

⁵⁴ Marrë nga Drançolli, F., *Trashëgimia Monumentale në Kosovë*, 170.

⁵⁵ Marrë nga <https://www.petermoore.net/kulla-osdautaj-kosovo/>

Siç shihet, kulla është një tip i banesave të fortifikuara që u ndërtuan masivisht në kushte të caktuara historike dhe që patën qëllime të caktuara. Kushtet materiale ndikuan që personi që kishte mundësi materiale me të mira, të ndërtoj një kullë që do ti shërbente për banim, për mbrojtje personale dhe mbrojtje të pasurisë.⁵⁶ Një kullë e tillë është edhe kulla e Isa Boletinit në Mitrovicë (shih fig. 14).



Figura 14 - Kulla e Isa Boletinit, Boletin (Mitrovicë).⁵⁷

Kjo kullë veçohet sepse i ka ruajtur të gjitha tiparet e kullës që ka ekzistuar ndër shekuj, veç se guri i përdorur për ndërtim të sajë e ka bërë edhe të fortë për mbrojtje nga armët e zjarrit por duke ruajtur elementet kyçe në brendi të sajë. Të gjitha këto veçori të kullës janë vlerë e shtuar për kullat. Andaj, pjesa në vijim, do të marrë në shqyrtim aspekte të ndryshme që kanë të bëjnë me disa nga karakteristikat e dekoracioneve të kullës.

2.2.2. Dekorimet e pjesës së jashtme të kullave

Format e dekorimeve paraqesin një vlerë e shtuar dhe ato duket të jenë të njëjta pothuajse në të gjitha trevat dhe rajonet shqiptare. Pra, dekoracionet që janë përdorur për të dekoruar kullat nuk ndryshojnë nga një rajon në rajonin tjetër.

⁵⁶ Krasniqi, M., *Gjurme e Gjurmime*, (Prishtinë, Instituti Albanologjik, 1979,) 343.

⁵⁷ Marrë nga Drançolli, F., *Kulla Shqiptare*, 96.

Elementet figurative dhe orientale në kulla paraqiten në fasadën kryesore, ku janë të hapurat, dritaret e mbuluara me harqat e odes së burrave, si dhe harkun e portalit kryesor. Në praktikë *“këto punime janë paraqitur dhe realizuar në plastikën e imët, sipërfaqësore, të plogësht, si dhe në të lartën, ndërsa në disa raste edhe në madhësinë natyrore”*.⁵⁸

Në disa fshatra të rretheve të Istogut, të Pejës dhe të Drenicës, paraqitet plastika sipërfaqësore, dhe kjo në portale kryesore. Një shembull i këtij dekorimi paraqitet edhe në figurën si me poshtë (fig. 15).



Figura 15 - Dobroshec, Gllogoc, Ylli i Davidit me hëne dhe yll.⁵⁹

Vlenë të theksohet se cilësia e dekorimeve në hapësirën e jashtme të kullave, ka shpërfaqur edhe gjendjen statusore të pronarit të kullës. Thënë ndryshe, sa ma e mirë gjendja financiare e pronarit, aq me shumë ishte në gjendje për të paguar mjeshtër me të mirë popullore për t'i bërë dekoracionet. Një është e sigurt se emëruet i përbashkët i këtyre dekorimeve është rëndësia e tyre që mbarte në vete rëndësi historike.

Dekoracionet janë paraqitur edhe në vende të ndryshme përveç kullës në fshatra që ka shërbye si banesë. Në qytetet të ndryshme, duket se dekoracionet ishin të një cilësie me të lartë se sa ato nëpër fshatra. Ndër to mund të veçohet kulla e Haxhi Zekës në kompleksin e Jashar Pashës por

⁵⁸ Fekjaz Drançolli, *Kulla Shqiptare*, 200.

⁵⁹ Marrë nga Fejas Drançolli, *Kulla Shqiptare*, 200.

edhe në kulla tjera në trevat tjera shqiptare. Figura me poshtë (fig. 16) pasqyron me se miri dy luan të skalitur në fasaden jugore në të dy anët e dritareve të odes se burrave.⁶⁰




Figura 16 - Luanët në dritaren e odes se burrave.⁶¹

Për të përmbyllur me dekorimet e jashtme të kullave, mund të ritheksohet se në efektin estetik të këtyre kullave, një rol të rëndësishëm, veçanërisht për nga cilësia luajti edhe cilësia e gurit si material ndërtimorë. Në ndërtimin e kullave vërehet se janë përdorur disa lloje të gurëve, si ata me ngjyrë të kuqërremtë, i përhimë dhe i bardhë, të gjithë këto lloje të gurëve ndikuan në zbukurimin e objektit në pamje estetike.⁶² Kjo vlenë edhe për kullat e rajonit të Istogut.

2.2.3. Dekoracionet në hapësirën e brendshme

Për dallim nga dekoracionet piktorale, dekoracionet e brendshme të kullave janë shumë më të shpeshta dhe janë përdorur në mas më të madhe. Dekoracionet në brendi të kullave si ato, në odën e burrave janë prezente pothuajse në çdo kulle. Kjo pavarësisht gjendjes ekonomike të pronarëve. Megjithatë, në disa oda të burrave vërehen punime të punuara më mjeshtri të hollë.⁶³

⁶⁰ Drançolli, F., *Kulla Shqiptare*, 201.

⁶¹ Marrë nga Drançolli, F., *Kulla Shqiptare*, 201.

⁶² Drançolli, F., *Kulla Shqiptare*, 203.

⁶³ *Idid*, 204.



Figura 17 - Kulla e Zenel Begut - Oda e burrave.⁶⁴




Figura 18 - Oda e Burrave - Trapazi.⁶⁵

Me rëndësi të veçante janë për tu theksuar karakteristikat e elementeve dekorative të odave të burrave: oxhaku si figura me poshtë, trapazanët, raftet, dera e odës, dollapët (si në figurën me poshtë), si dhe tavanet dekorative. Këto elemente artistike dekorative ekzistojnë në çdo kulle si ndërtime popullore.⁶⁶ Madje edhe në ditët e sotme mund të vërejmë dekorime të tavaneve në disa oda të burrave, kryesisht nëpër fshatra të trevave të Kosovës anë e mbanë vendit.



Figura 19 - Dekoracione në oxhakun e odës së burrave⁶⁷




Figura 20 - Dollap i bukës në orën e burrave⁶⁸

Dollapët si elemente dekorative mbyllen me kapak qoftë ai një apo dy krahësh, dhe i punuar nga druri, të cilët sillen rreth një boshti vertikal. Në pjesën e sipërme dollapët mund të jenë të çelur,

⁶⁴ Drançolli, F., *Kulla Shqiptare*, 210.

⁶⁵ *Ibid.*, 102.

⁶⁶ *Ibid.*, 204.

⁶⁷ *Idid.*, 204.

⁶⁸ *Idid.*, 205.

dhe shërben si sergjen. Kjo pjese është e profilizuar dhe në disa raste e zbukuruar me motive gjeometrike apo me lule të botës bimore.⁶⁹

Sa i përket dollapit të bukës, ai është i profilizuar dhe në disa raste, në pjesën e sipërme, paraqitet rozeta e gdhendur në dru. Të zbukuruara janë dhe oxhakët e odës së burrave dhe dera e odës së burrave (si figura e me poshtme; fig 21) prej druri. Në këtë rast, po sikur edhe të dollapët, në sipërfaqet e rrafshëta të rimesuara, vendosen listelat e profilizuara, duke realizuara forma të ndryshme gjeometrike, si katror, romb, apo trekëndësh. Këto dërrasëza të profilizuara në dera dhe në dollap, kryejnë edhe efektin e vet plastik, gjë që arrihet me ndihmën e lojës së dritëhijes.⁷⁰

Një element tjetër karakteristike e odës së burrave është edhe tavani i divanhanës i cili është i punuar prej drurit. Mbi vendin, ku bashkë lidhën këto dërrasa, vendosen listelat e profilizuara gjarpërorë, duke formuar sipërfaqe katrore si në kullën e Gockajve dhe kullën e Borqeve në figurat si me poshtë.⁷¹




Figura 21 - Pejë Detaj Tavani.⁷²




Figura 22 - Dekoracione-Rozeta.⁷³

⁶⁹ Drançolli, *Kulla Shqiptare*, 204.

⁷⁰ *Idid.*

⁷¹ *Ibid.*, 206.

⁷² *Idid.*, 206.

⁷³ *Idid.*, 204.

2.3. Objektet arkitektonike në Kosovë të përfshira në hulumtim.

Qëllimi kryesor i hulumtimit tonë është trajtimi i çështjes së trashëgimisë kulturore, e në veçanti i monumenteve kulturore në qytetin e Prishtinës: (1) Shkolla fillore “Elena Gjika,” (2) ish-hotel Unioni, dhe (3) ish ndërtesa e akademisë së shkencave të Kosovës. Për më tepër, të shohim se a janë të evidentuara dhe cila është gjendja aktuale e tyre. Për t’ju përgjigjur kësaj pyetjeje, kemi kërkuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Departamenti i Trashëgimisë Kulturore, Qendrës Rajonale në Prishtinë, që të na sigurojë materialin e nevojshëm për hulumtim. Përshkrimi i tyre në këtë punim është bërë nga materiali i siguruar në këtë department nga Znj Merita Gorani Bajri dhe Z. Agim Haliti, Mjellma Halili, Fatbardh Mustafa, Genta Deva. Për t’ju përgjigjur pyetjes së dytë dhe të tretë të hulumtimit, ne kemi eksploruar dokumentet zyrtare relevante të gjetura në gazetën zyrtare si dhe në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Kosovë.

2.3.1. Shkolla fillore “Elena Gjika” (Prishtinë).

Pjesë e këtij hulumtimi është shkolla fillore “Elena Gjika” e cila është e ndërtuar gjatë periudhës modern në vitin 1926 dhe gjendet në Prishtinë në zonën kulturo-historike të qytetit. Në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit kjo shkollë përkon të jetë e evidentuar, dhe posedon kopjen e planit dhe fletën poseduese. Nga të dhënat e kësaj ministrie, arkitektura e objektit është ndikuar nga ajo austrohungareze. Kjo shkollë është pronë lokale/institucionale dhe e vendosur në mbrojtje të përkohshme që nga viti 2012, dhe që nga ndërtimi i saj ka pasur të njëjtin destinim, pra shkollë. Ndërtimi është sistem i ndërtimit konstruksion masiv dhe materialet e përdorura për ndërtimin e këtij objekti janë: themeli është i ndërtuar me llaç gëlqeror, tullat janë të plota dhe poashtu me llaç gëlqeror, ndërsa konstruksioni i kulmit është ndërtuar prej drurit dhe mbulesa me tjegulla të reja. Gjendja e përgjithshme e ndërtesës, themelet, muret, dhe pjesët tjera të brendshme janë në përgjithësi të ruajtura. Janë bërë disa intervenime në fasadë, për më tepër në kulm dhe dritare, dhe gjatë riparimit është ruajtur forma dhe ndarjet e kapakëve të dritareve. Mirëpo, objekti ka pësuar disa plasaritje dhe humbje të llaçit në fasadë. Në përgjithësi, aktualisht ndërtesa është vlerësuar të jetë në gjendje të favorshme me disa kërcënime të lokalizuara. Oborri i saj, jo shumë i gjerë nuk është edhe aq i mirëmbajtur.



Figura 23 - Shkolla fillore “Elena Gjika”.⁷⁴

2.3.2. Ish Hotel Unioni (Prishtinë)

Objekti i dytë i përfshirë në hulumtimin tonë është ish Hotel Unioni në qendër të qytetit të Prishtinës, objekt ky i cili nuk ekziston më.

Inventarizimi i tij ishte bërë në vitin 2000, dhe orenditë ndërlidhëse ishin kryesisht piktura dhe ikona të cilat ishin vendosur në muret e ndërtesës. Ky objekt ndodhej në zonën historike të Prishtinës, në mjedisin e trashëgimisë kulturo-Historike afër ndërtesave tjera me arkitekturë tradicionale si Xhama e Çarshisë, Shatërvani, Enti i statistikave të Kosovës, shtëpia e banimit Hajdar Riza, etj. I ndërtuar në vitin 1927, dhe materiali i përdorur për ndërtimin e themelit ishte gur i përforcuar me Kampada prej Beton armesë, muret ishin ndërtuar nga tullat e pjekura, kulmi ishte nga druri dhe mbulesa me tegolla. Mbikëqyrës i punimeve ishte arkitekti austriak Andrija Kremer, dhe stili i ndërtimit të tij ishte i përzier, neo renesansës, neo barok dhe artit bashkëkohor. Kjo e bënte këtë ndërtesë të jetë nga të paktat ndërtesa në Prishtinë nën ndikimin e arkitekturës evropiane. Qëllimi i ish Hotel Unionit ishte të jetë objekt afarist. Në fillim kur ishte ndërtuar,

⁷⁴ Foto e marrur nga Arkivi ndër komunal, përpunuar nga Arben Lllapashtica. E huazuar nga internet me datën: 09/11/2019, https://dtk.rks-gov.net/tkk_objekti.aspx?id=8482

ndërtesa ishte quajtur “Hotel Skënder begu,” dhe kjo mund të verëhej edhe nga pikturat dhe ikonat e vendosura nëpër muret e saj.



Figura 24 - Ish-Hotel Unioni, Prishtinë.⁷⁵



Figura 25 - Ish Hotel Skander Beg në vitin 1923, në kohën kur kishin arritur veturat e para në Prishtinë.

⁷⁵ Foto e huazuar nga internet me datën: 10/11/2019, në

[https://sq.wikipedia.org/ëiki/Ish_hotel_%22Unioni%22_\(Prishtin%C3%AB\)#/media/Skeda:Ish_Hotel_Unioni,_Prishtin%C3%AB_03.jpg](https://sq.wikipedia.org/ëiki/Ish_hotel_%22Unioni%22_(Prishtin%C3%AB)#/media/Skeda:Ish_Hotel_Unioni,_Prishtin%C3%AB_03.jpg)

Pas Luftës së Dytë Botërore, ky hotel kaloi në pronësi të shtetit dhe mori emrin Hotel Union. Pas Luftës së fundit në Kosovë, në vitin 2008 Komuna e Prishtinës filloi diskutimet për të ardhmen e tij duke paraqitur synimet për rrenimin e tij. Arsyeja për këtë gjë sipas zyrtarëve komunal ishte se Hotel Skënderbeu nuk zotëron asnjë vlerë të rëndësishme arkitektonike sipas raportimit të disa ekspertëve të cilët deklaruan që 80% e vlerave historike të tij ishin dëmtuar në mënyrë të pariparueshme. Gjithashtu rrenimi i tij ishte i nevojshëm edhe për të hapur rrugën për bulevardin e ri “Ibrahim Rugova” që ishte planifikuar të ndërtohej. Mirëpo, instituti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kosovës rekomandoi restaurimin e tij të menjëhershëm. Fatkeqësisht, në vitin 2009 ndërtesën e ish Unionit e kishte kapluar zjarri. Në vitin 2010 u bë marrëveshja në mes të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor dhe shtëpisë italiane të modës, United Colors of Benetton që të rivendoset objekti në gjendje sa më të përafërt me gjendjen e tij origjinale dhe në vitin 2013 inauguroi hapësirën prej 2.000 metrash katrorë. Të paktën pamja është e përafërt dhe funksioni është i njëjtë, pra afarist.

2.3.3. Ndërtesa e Akademisë së Arteve dhe Shkencave të Kosovës (Prishtinë).

Ndërtesa e fundit e përfshirë në këtë hulumtin është ajo e Akademisë së Arteve dhe Shkencave të Kosovës në Prishtinë. Kjo ishte një shtëpi ishte ndërtuar në shekullin XIX dhe paraqet një shembull të rrallë të arkitekturës së vjetër qytetare të banimit. Ishte pronë të Tefik Rushit Mirashit dhe e familjes Domaniku. Kjo ndërtesë është listuar në Listën e Trashëgimisë për Mbrojtje të Përkohshme që nga viti 2012, 2013, dhe 2014, sipas vendimit 4164/2014, me datë 01.10.2014 me numër unik të databazës 2781. Vendimin për mbrojtje kjo ndërtesë e ka pasur që nga viti 1955, me numër të vendimit 952/1955.

Kjo shtëpi i takon tipit të shtëpive me çardak e ndërtuar në dy kate me zhvillime kompozicionale të ndryshme njëra me tjetrën. Materiali i përdorur në ndërtimin e themeleve kësaj shtëpie ishte gur me llaç, baltë dhe hatulla, muret ishin të ndërtuara me shtylla të drurit, çepiq, konstruksioni i kulmit prej drurit me tjegulla dhe çeremide, si dhe tavanet me çatme dhe llaç balte. Ajo shquhet me drugdhendje, dritare me variacion të dukshëm të ndërtuara kryesisht me struktura prej skeleti druri të grupuara në njësi dyshe dhe treshe, të mbuluara me grila prej druri të dekoruar. Gjendja aktuale e saj nuk është mjaft e mirë, pasi që shumica e tjegullave të kulmit janë dëmtuar

dhe kur ka të reshura uji depërton brenda dhe kështu dëmton muret, konstruksionet e kulmit dhe dyshemet e katit.

Gjatë viteve 1964-1965 kjo ndërtesë ishte rikonstruktuar në tërësi me material të ri, dhe kjo u bë për arsye të dëmtimeve të mëdha që kishte. Poashtu janë bërë ndryshime edhe tek shkallët hyrëse ku ishin vendosur shkallë të reja, ishin shtuar edhe muret ndarëse, qerpiç ishin zëvendësuar me blloqe dhe pati edhe rregullim të oborrit. Më parë kjo ndërtesë ishte e ndarë në dy tërësi të pavarura me hyrje të veçanta, dhe pas rikonstruktimit këto dy tërësi janë bashkuar në mënyrë që t'i përshtateshin funksionit të ri afarist. Që nga viti 1975 deri në vitin 1994, hapësirat në këtë ndërtesë janë përdorur nga Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Mirëpo, në 1999 ata u nxorrën me dhunë nga policia serbe. Kjo ndërtesë sot përdoret si zyre e Shoqatës së të Burgosurve Politikë dhe sipas autorëve të raportit të Departamentit të Kulturës pranë Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, është dëshmi e vlerave të shumta të natyrës shpirtërore, si dinjiteti njerëzor, mikpritja, besnikëria, të cilat janë krijuar gjatë epokave të mëparshme dhe vazhdojnë të janë prezente edhe në ditët e sotme.



Figura 26 - Ndërtesa e ish Akademisë së Shkencave dhe Arteve⁷⁶

⁷⁶ Foto e marrë nga internet me datën: 09/11/2019, në:

<https://www.radiokosovaelire.com/akademia-e-shkencave-dhe-arteve-te-kosoves-te-mbaje-nje-mbledhje-perkujtimore-ne-nderim-te-albanologut-kanadez-robort-elsie/>

Në figurën 26 mund të shohim se si duket ish ndërtesa e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës në ditët e sotme, ku mund të vërejmë edhe një mbishkrim që i është bërë k una lë të nënkuptojmë që qytetarët e Prishtinës nuk janë të vetëdijshëm për rëndësinë e këtyre objekteve me vlera kulturore për shtetin tonë.

KAPITULLI TRETË

MBROJTJA DHE RUAJTJA E ARKITEKTURË TRADICIONALE

3.1. Trajtimi dhe ruajtja e aseteve të arkitektures tradicionale

Për ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, si faktor me rëndësi është legjislacioni, por edhe ndërhyrjet si konservimi dhe restaurimi i monumenteve. Konservimi bëhet nga profesionist të cilët trajtimin dhe menaxhimin e kryejnë në mënyrën e duhur që fazat e konservimit të monumentit i bëjnë të dallueshme dhe jo të njëtrajtshme pa dallim. Ky proces duhet të jetë i detajizuar që çdo fazë e ndërtimit në objekt duhet të ketë dallueshmëri.

Kamillo Bioto (arkitekt), i cili krijoi bazat e shkollës moderne për restaurim shkencor, vlerësoi së pari domethënien historike të veprës arkitekturore dhe ishte për ruajtjen e të gjitha fazave të ndërtimit në monument. Bioto në ndërhyrjet e sheh rrezikun e dëmtimit të vlerave autentike të monumentit prandaj sugjeron konservim përpara restaurimit. Ai potencoi se nëse restaurimi i një monumenti është i domosdoshëm, sugjeroi që ndërhyrjet e reja të jenë të dallueshme për të mos i falsifikuar vlerat e monumentit.⁷⁷

Doktrina e restaurimit ka filluar në shekullin XIX, me teorinë e Viole Lë DYK (1814-1879) i cili me pikëpamjet e tij konkludoi se: *"Të restaurosh një ndërtesë do të thotë të risjellëshatë në një gjendje e cila mund të mos ketë qenë kurrë"*. Sipas këtij koncepti teoria e Viole Le Dyk e cenonte thelbin e vlerave të monumentit (autenticitetin).⁷⁸

Kundër kësaj teorie filluan kritikën e mjeshtrit francez Anatol Franc me rastin e restaurimit të kështjellës *Prrfond*, duke pohuar se janë murosur shumë gurë të rinj në kështjellë. Si kundërshtar të pikëpamjeve të Viole Lë Dyk paraqitet në konceptet e tij anglezi Xhon Raskin i cili përqendrohet me vlerën e monumentit duke e konsideruar monumentin si vepër të papërsëritshme.⁷⁹ Raskin shfaqet kundërshtar i hapur i ndërhyrjeve në monument, pra i restaurimit.

Raskin ka merita se përmes pikëpamjeve të tij mbron vlerat unike dhe të papërsëritshme të monumentit. Raskin në idetë e tij shprehë: *"ndërtesa e vjetër duhet të shoqërohet vazhdimisht*

⁷⁷ ChWB, *Plani lokal për trashëgimi kulturore*, 16.

⁷⁸ Emin Riza, *Restaurimi i banesave popullore*, (Tiranë: IMK, 1981), 11.

⁷⁹ Aleksandër Meksi, *Restaurimi i monumenteve të arkitekturës*, (Tiranë: EUGEN, 2004), 19.

me përkujdesje ashtu si çdo gjallesë, në mënyrë që jeta e monumentit të zgjatet, por që ka edhe të që të vdesë si të gjitha gjallesat tjera".

Rastin me pikëpamjet e tij arriti të definoj thelbin e monumentit, por pa i treguar rrugët për zgjatje të jetës së monumentit dhe pa prekur domethënien e tyre historiko-kulturore. Pas pikëpamjeve të francezit Viole Lë DYK dhe anglezi Xhon Raskin, dalin teoritë e reja të shkollës italiane të restaurimit me Kamillo Boiton siç cekëm më lartë.

Lluka Beltrami (1854-1933), (avokat), *kundërshton restaurimin stilistik* apo të analogjisë, duke mos e mohuar thelbin e njësisë së monumentit nëpërmjet rindërtimit. Lluka Beltrami duke vlerësuar çdo vepër si krijim unik, kur shtrohet çështja e rindërtimit pjesor apo tërësor të monumentit bazohet në të dhëna historike dhe arkivore. Beltrami pranon rikonstrukcionin, nëse bazohet mbi të dhëna historiko-dokumentare, pra pikëpamjet e tij janë ato të restaurimit mbi dokumente apo kopje të origjinalit. Gustavo Xhovanoni (1873-1947), (inxhinier), konsolidoi pikëpamjet e restaurimit shkencor, dhe është nismëtar i trajtimit të problemeve të monumenteve dhe restaurimit të tyre në plan ndërkombëtar. Merita e Gustavo Xhovanonit është se e bëri shtrirjen e hapësirës së monumentit në të ashtuquajtur arkitekturë minore, si dhe në qendra historike. Ishte edhe nismëtar i kartës së Athinës. Në këtë kohë shfaqen edhe mendimet ⁸⁰ e Ambrosio Anonit duke e mbivlerësuar problematiken e çdo monumenti të veçantë, pra raste të veçanta.

Antoni si dhe Xhovanoni i jepnin rëndësi ruajtjes së qendrave historike. Dokumenti i parë ndërkombëtar i cili trajton problematikën e monumenteve dhe të ndërhyrjeve restauruese është Karta e Athinës e vitit 1931.⁸¹

Karta e Athinës ishte një dokument rekomandues e që ndahej në 10 pjesë. Në këtë dokument u shfaqën prirjet e largimit nga rindërtimet, duke parapëlqyer mirëmbajtjet e vazhdueshme, gjithnjë duke pasur parasysh shfrytëzimin e monumenteve për funksione që nuk dëmtojnë vlerat e monumentit.

Ruajtja nënkupton ndërmarrjen e masave për të mos ndryshuar gjendjen eksistuese të një monumenti, siti, apo zone historike. Trashëgimia kulturore është trashëgimi materiale dhe shpirtërore të një grupi ose shoqërie të cilat janë të trashëguar nga gjeneratat e kaluara tek gjeneratat e tashme, është thelbi i identitetit të një kombi i cili brez pas brezi në periudha të ndryshme e ka kultivuar dhe ruajtur atë. Vendet më të zhvilluara e kanë ruajtur dhe e kanë

⁸⁰ ChWB, *Plani lokal*, 16.

⁸¹ Aleksander Meksi, *Restaurimi i monumenteve të arkitekturës*, 20.

promovuar trashëgimin kulturore ku sot, janë destinacionet më atraktive për shumë turistë. Por ekzistojnë pyetje të ndryshme mbi kulturën, trashëgiminë kulturore dhe lidhjen e saj me zhvillimin e turizmit kulturor. Ky koncept është trajtuar nga antropologu britanik Edward Burnett Tylor në *Primitive Culture (1871)*, sipas të cilit; "kultura është një tërësi komplekse që përfshinë njohuritë, besimin, artin, parimet, ligjin, zakonet dhe gjithçka tjetër të krijuar nga aftësitë e njeriut si anëtar i shoqërisë " ⁸² . Me nënshkrimin e Kartës së Venecias në 1964, u dhanë disa rekomandime në lidhje me përcaktimin e konceptit të trashëgimisë kulturore.

Lufta e dytë botërore shkatërroi në masë të madhe institucione kulturore, shkencore, edukative dhe arsimore. Pas mbarimit të kësaj lufte në konferencën e Londrës të mbajtur me 1945 u themelua organizata e kombeve të bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë, (UNESCO). Për mbrojtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore u themelua Qendra studimore ndërkombëtare për monumentet dhe tërësitë monumentale (ICOMOS)⁸³ .

Në këtë kohë të globalizimit të lartë UNESCO luan rol të rëndësishëm në ruajtjen e identitetit kulturorë. Pas UNESCO-s filloi organizimi i organizatave jo qeveritare si : Këshilli Ndërkombëtar i Muzeve(1946), Unioni Ndërkombëtar për Konservimin e Resurseve Natyrore (1956), kjo është organizatë qeveritare dhe ndërqeveritare. Ky union luan rol të rëndësishëm, sepse në këtë organizatë rëndësi i kushtohet edhe trashëgimisë natyrore. Në vitin 1956 në Romë themelohet *Qendra Ndërkombëtare për Prezervim dhe Restaurimin e Trashëgimisë kulturore*, kjo organizatë është ndërqeveritare. Në vitin 1964 në kuadër të ICOMOS themelohet (*Këshilli Ndërkombëtar për Monumentet dhe Zonat të Mbrojtura*) me seli në Paris⁸⁴ . Sipas Konventës së UNESCO-s (Neni 1) *trashëgimi kulturore konsiderohen:*

- *Monumentet*; veprat arkitekturore, veprat skulpturore dhe të pikturuara, elementet apo strukturat me natyrë arkeologjike, mbishkrimet, vendbanimet shpellore dhe kombinime të elementeve, të cilat kanë vlera universale nga këndvështrimi i historisë, artit dhe shkencës.
- *Grupe ndërtesash* të ndara ose të bashkuara, të cilat për shkak të arkitekturës së tyre apo vendit që zënë në mjedis, kanë vlera të jashtëzakonshme universale nga këndvështrimi i historisë, artit dhe shkencës.

⁸² J.Jokilehto; *Definition of culture heritage* (Originally for ICCROM, 1990); Revised for CIF: 15 January 2005; ICCROM Working Group 'Heritage and Society', JJ; 4.

⁸³ ICOMOS-Këshilli Ndërkombëtar për monumente dhe zona të mbrojtura

⁸⁴ *Ididem*.

- *Sitet, veprat e njeriut ose veprat e kombinuara të njeriut dhe natyrës, zonat që përfshijnë vende arkeologjike, të cilat janë me vlera universale nga këndvështrimi historik, estetik, etnologjik dhe antropologjik⁸⁵. Sipas nenit 4 të kësaj Konvente "trashëgimia është detyrë për të siguruar identifikimin, mbrojtjen, konservimin, prezantimin dhe transmetimin në brezat e ardhshëm të trashëgimisë botërore natyrore dhe kulturore".*

Në fund të shekullit të XX, koncepti i trashëgimisë kulturore i dhënë nga UNESCO dhe i pranuar ndërkombëtarisht përfshinë trashëgiminë kulturore materiale dhe jomateriale ashtu sikurse edhe mjedisin. Në Konventën e UNESCO-s në 2003, trashëgimia jo-materiale u përcaktua si: *"Praktikat, përfaqësimet, shprehjet, njohuritë, zotësitë, ashtu sikurse instrumentet, objektet, zonat kulturore së bashku me komunitetet, grupet dhe individët si pjesë e trashëgimisë kulturore të tyre. Kjo trashëgimi kulturore jo-materiale e transmetuar brez pas brezi është krijuar nga komunitetet përgjegjës për mjedisin e tyre, si lidhje e natyrës me historinë duke u siguruar atyre identitetin dhe vazhdimësinë ashtu sikurse promovimin e respektit për diversitetin kulturor dhe krijimtarinë njerëzore.*⁸⁶

Në vitin 1990 Komiteti ndërkombëtar për trashëgimi filloi projektin për studime globale me qëllim të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore për ta siguruar listën reprezentative të monumenteve të kulturës. Si rezultat i koncepteve të globalizimit viteve të fundit doli se trashëgimia kulturore nuk i takon as një individ, as një identiteti por është trashëgimi e gjithë njerëzimit. Me qëllim të ruajtjes së vlerave të trashëgimisë historike, kulturore dhe natyrore prej vitit 1990 e deri në vitin 1999 janë aprovuar 33 dokumente me karakter ndërkombëtar.

3.2. Konservimi dhe restaurimi

Me rëndësi të veçant janë edhe ndërhyrjet për ruajtjen dhe shpëtimin e tyre në objektet e trashëgimisë kulturore. Nga vjetërsia që kanë, trajtimi i tyre nëpër periudha të ndryshme kohore, dridhjet e tokës (termetet), dhe një varg elementesh kanë bërë që shumë nga monumetet e

⁸⁵Yahaya A.,2006, *The Scope and Definitions of Heritage* : From Tangible to Intangible, International Journal of Heritage Studies (Routledge) Vol.12,No.3, 295.

⁸⁶UNESCO, *Convention for the Safeguarding of the Intangible Cultural Heritage*, 32nd Session of the General Conference ,Paris, 2003.

trashëgimisë kulturore të pësojnë dëmtime. Andaj me kohë është dashur të merren masa preventive ndaj këtyre objekteve në formën e restaurimit, konservimit, etj.

Konservimi - nënkupton ruajtjen e ndërtesave, siteve, koleksioneve dhe qyteteve historike duke përfshirë këtu mirëmbajtje, riparimin, konsolidimin dhe përforcimin ku qëllimi kryesor të ruhet autenticiteti dhe integriteti i burimit kulturor.

Konsolidimi - është vendosja e materialit si shtesë fizike, ngjitëse, apo mbështetëse në materialin ekzistues të monumentit kulturor.

Restaurimi - nënkupton nxjerrjen në pah të gjendjes origjinale të monumentit brenda kufijve të materialeve ekzistuese që dallon nga qëllimi i mëparshëm i kthimit të origjinalitetit të monumentit përmes rindërtimit të formës së tij të humbur.

Konservimi – nënkuptojmë krijimin e kushteve të përshtatshme dhe marrjen e masave paraprake për ruajtjen e trashëgimisë kulturore, duke përfshirë edhe mirëmbajtjen.⁸⁷

Rindërtimi – duhet bazuar mbi dokumentet arkeologjike dhe arkitekturore. Rindërtimi nënkupton ndërtimin nga e para është aplikuar si metodë e përshtatshme pas luftërave, tërmeteve, zjarreve. Zhvendosja e monumentit nga vend ndodhja origjinale nuk duhet të lejohet, përveç kur ky proces justifikohet përmes interesave me rëndësi madhore kombëtare ose ndërkombëtare.

Ruajtja e trashëgimisë kulturore në dokumentet e qeverisë së Kosovës cilësohet të jetë një nga prioritetet e programit qeverisës deri në vitin 2018. Rëndësia e ruajtjes së trashëgimisë kulturore kërkohet edhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës e cila gjithashtu e promovon ruajtjen dhe mbrojtjen e të gjitha monumenteve kulturore dhe fetare për të gjitha komunitetet.

3.3. Korniza ligjore

Ligji Nr. 02/L-88, i vitit 2008, mbi vlerat e monumenteve të trashëgimisë kulturore si thesar i ndërtuar ndër shekuj dhe objektivë e këtij ligji janë mjetet legale dhe teknike për inventarizim, dokumentim, selektimi, mbrojtje, konservim, restaurim, administrim, prezantim dhe përhapje të tyre në pajtim me kartat dhe konventat ndërkombëtare, pavarësisht nga pronësia e trashëgimisë kulturore nën mbrojtje. Gjithashtu, ky ligj vendos edhe marredhëniet në mes të pronarëve dhe shfrytëzuesve të këtyre monumenteve. Këtu përfshihet trashëgimia arkitekturale, arkeologjike e

⁸⁷Ligji për trashëgimi kulturore, në amëzën assembly – kosova.org.

luajtshme dhe shpirtërore, dhe të gjitha këto duhet të qeverisen nga legjislacioni i cili rregullon statusin tyre dhe të komuniteteve fetare në Kosovë.⁸⁸

Qëllim tjetër i këtij ligji është që të rregullojë legalisht fushën e trashëgimisë kulturore në lidhje me ruajtjen, mbrojtjen, qasjen publike, komunikimin dhe pajisjen e burimeve të domosdoshme me qëllim që trashëgimia të shijohet nga gjeneratat e tashme dhe të jetë e gatshme për gjeneratat e ardhshme si një dokument historik dhe kulturor.

Dokumentimi i trashëgimisë kulturore sipas këtij ligji nënkupton paraqitjen e vlerave tipologjike dhe faktike, si dhe faktorëve me interes sipas neneve 2.2, 2.3, 2.4 dhe 2.5 të këtij ligji përmes mjeteve grafike dhe fotografike, dhe të dhënave të shkruara.

Në anën tjetër, restaurimi i këtyre monumenteve nënkupton veprimtarinë me qëllim të ruajtjes dhe ekspozimit të vlerave të trashëgimisë kulturore. Restaurimi i kësaj trashëgimie duhet të bëhet sipas dispozitave ligjore, ku për të gjitha ndërhyrjet e mundshme duhet të mirret leja nga Insitucioni kompetent.

Buxheti i konsoliduar i Kosovës duhet të siguroj fondet për hulumtim, dokumentim, përzgjedhje, mbrojtje, konservim, restaurim, administrim, prezantim dhe përhapje të trashëgimisë kulturore.

⁸⁸ Ligji për trashëgiminë kulturore 2008, Ligji Nr. 02/L-88. Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Prishtinë: Viti III/Nr. 29/o1 korrik 2008. Qasur nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2533>

Konkluzionet

Në ruajtjen, mbrojtjen dhe prezantimin e Trashëgimisë Kulturore të Kosovës, janë të angazhuara një numër organizatash dhe institucionesh, të cilat japin kontributin e tyre rreth politikave dhe projekteve që kanë të bëjnë me trashëgiminë kulturore në Kosovë. Edhe pse ruajtja e kësaj trashëgimie kulturore është e rregulluar me ligjet në Kosovë, dhe ka buxhet të ndarë për restuarimin e tyre, siç e kemi vërejtur gjatë hulumtimit tonë, ende nuk plotësohen kushtet minimale për ruajtje, mbrojtjen dhe prezantimin adekuat dhe ashtu siç e meriton trashëgimia kulturore. Kemi mundur të shohim që për arsye të ndryshme shumë nga këto monumente janë dëmtuar apo shkatërruar plotësisht, dhe me to edhe shumë pjesë të historisë dhe memorjeve kolektive.

Gjithashtu duhet theksuar se përveç për autoritetet përkatëse në Kosovë, trashëgimia kulturore është një temë relevante edhe për një sërë agjencisë zhvillimore ndërkombëtare, për një numër donatorësh, përfaqësish diplomatike, strukturash fetare dhe organizatash joqeveritare. Të gjitha këto do të duhej të ishin më të koordinuara në realizimin me sukses përmes projekteve objektivat dhe politikat për trashëgiminë kulturore në Kosovë.

Bazuar në të dhënat e këtij hulumtimi në dëshirojmë të ngrisim vetëdijen e qytetarëve të Kosovës, si në nivelin lokal ashtu edhe në atë qendrorë, që trashëgimia kulturore, në rastin tonë objektet tradicionale në Kosovë, duhet të ruhen, të mbrohen dhe të dokumentohen, sepse janë shumë të rëndësishme për historinë e popullit tonë. Për të arritur këtë, duhet të bëhen kampanja të vetëdijësimit të popullatës ekzistencën e këtyre objekteve dhe monumenteve, për rëndësinë e tyre, dhe të parandalohet dëmtimi i tyre por edhe të dokumentohen të gjitha ndryshimet që ju ndodhin këtyre objekteve në mënyrë që të bëhet restaurimi adekuat.

Gjithashtu, rekomandohet një hulumtim i spektrit më të madh ku do të përfshiej një numër më i madh i objekteve të arkitekturës tradicionale në tërë Kosovën me qëllim të përfshirjes së tyre në të gjithë librat për lëndën e trashëgimisë kulturore me të cilën mësojnë nxënësit nëpër shkolla.

Burimet dhe literatura:

Meksi, A. (2004), *Restaurimi i monumenteve të arkitekturës*, Tiranë: EUGEN.

Andrew, H. & Riedlmayer, A. (2000) Monument and Crime: The deconstruction of historic architecture in Kosovo. *JSTOR*, 1, 108-122.

Salihu, A. (2018), *Lexim filozofik i arkitekturës*, botoi SHFK, Prishtinë.

Beqiri, N. “Kullat Shqiptare, Djegia, Rrënimi dhe Ri Ngritja e tyre,” 19 Shtator, 2013, *radiokosova e lire*. <http://ww.radiokosovaelire.com/mr-prof-nezir-beqiri-kullat-shqiptare-djegia-rrenimi-dhe-ri-ngritja-e-tyre/>

CHWB Kosovo (2010). Arkitektura Tradicionale dhe Metodrat e Dokumentimit. Qasur nga http://chwb.org/kosovo/wp-content/uploads/sites/3/2014/07/Publication_2010_6.pdf

Doli, F. (2001) *Arkitektura tradicionale popullore e Kosovës*. Kosovë.

Drançolli, F. (2001). *Kulla Shqiptare*, Kosovë: Rezniki.

Drançolli, F. (2004). *Destruction of Albanian Kulla*. Kosovë: Rezniki.

Drançolli, F. (2011). *Trashëgimia Monumentale në Kosovë*, Prishtinë: Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Earnest, J. (2015). Post-conflict reconstruction – a case study in Kosovo. *International Journal of Emergency Services*, 4(1), 103-128.

Emini, R. (1981), *Restaurimi i banesave popullore*, Tiranë: IMK,1981.

Emini, R. (2009). *Qyteti dhe banea qytetare shqiptare shek. XV-XIX*. Shqipëri: Drita

Fabio, M. (2006). The loss of the Kosovo cultural heritage, *Web Journal on Cultural*, 28.

Herscher, A., & Riedlmayer, A. (2000). Monument and Crime: The Destruction of Historic Architecture in Kosovo. *Grey Room*, (1), 108-122

Hoxha, V., Andrews, K.D. & Salaj, A.T. (2014). Cultural factors affecting urban planners' intentions to regulate public space in Prishtina, Kosovo. *Urbani izziv*, 25(2), 76-89.

ICOMOS-Këshilli Ndërkombëtar për monumente dhe zona të mbrojtura

IKS, (2006). *Një e ardhme për të kaluarën e Prishtinës*, Prishtinë.

KIPRED (2005). *Leksionet e mesuara: Komisioni i Pavarur Ndërkombëtar për Kosovën*. Oxford University Press.

Krasniqi, M. (1979), *Gjurme e Gjurmime*, Instituti Albanologjik, Prishtinë.

Krasniqi, N. (2017). *Zhvillimi i Kulturës Shqiptare me Ndikime Orientale Prej Shekullit XVIII deri në Fillimet e Rilindjes Komëtare*. Instituti Albanologjik, Prishtinë.

Krasniqi, J. (2006). *Kthesa e Madhe: Ushtria Çlirimtare e Kosovës*, Prishtinë: Buzuku.

Komuna e Prishtinës, Republika e Kosovës. <https://kk.rks-gov.net/prishtine/qyteti/lidhjet-ne-web/>

Ligji për trashëgiminë kulturore 2008, Ligji Nr. 02/L-88. Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Prishtinë: Viti III/Nr. 29/01 korrik 2008. Qasur nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2533>

J. Jokilehto. (1990). *Definition of culture heritage* (Originally for ICCROM, 1990); Revised for CIF: 15 January 2005; ICCROM Working Group 'Heritage and Society', JJ; 4.

Osmani, J. (2003). *Vendbanimet e Kosovës, Prishtina, Kasrtioti dhe Fushë Kosova*. Prishtinë, Shkrola.

Roberts, A. (1999), NATO's 'Humanitarian War' over Kosovo. *Survival*, 41(3), 102-123.

Rodriguez, A. & Pettus, K. (1990). The importance of vernacular traditions. *JSTOR*, 22(3), 2-4.

Salihu, A. (2018). *Lexim filozofik i arkitekturës, botoi SHFK*, Prishtinë, 217.

Stublla, Sh. (2007). *Mbiejtresa, Aspekti muzeor*. Prishtinë, CIP.

Sieckmeyer, D., & Sieckmeyer J. (2010). *Kosova – Kosovo: NewBorn, Seltman+Sohne*, Koln.

Toska, E & Bllaci, M. (2011). "7 Projekte të Konservimit të Integruar në Komunën e Junikut," (Prishtinë, CHwB - Trashëgimia Kulturore pa Kufij, zyra në Kosovë), 28.

Wells, C. (1986). Old claims and new demands: Vernacular architecture studies today. *Perspectives in Vernacular Architecture*, 2(1), 1-10.

- UNESCO (2004). Cultural Heritage in South-East Europe: Kosovo. Cultural heritage in Kosovo. Protection and Conservation of a multi-ethnic heritage in danger. 1-13.
- UNESCO, *Convention for the Safeguarding of the Intangible Cultural Heritage*, 32nd Session of the General Conference, Paris, 2003.
- Ulusoy, M., & Kuyrukcu, E.Y. (2012). The meaning and importance of the traditional architecture in architecture education; Gönen winter school model. *Procedia – Social and Behavioural Sciences* 47, 220-2126
- Yahaya A. (2006). *The Scope and Definitions of Heritage: From Tangible to Intangible*, International Journal of Heritage Studies (Routledge) Vol.12, No.3, 295.